



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E INDUSTRIË,
NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

STUDIMI I ZINXHIRIT TË VLERËS PËR SEKTORIN E PRODUKTEVE MINERALE JO METALIKE

Prishtinë, 2022



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E INDUSTRIË,
NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

STUDIMI I ZINGJIRIT TË VLERËS PËR SEKTORIN E PRODUKTEVE MINERALE JO METALIKE

KOMENT: Ky studim është financuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pikëpamjet e shprehura në këtë raport i përkasin autorëve të D&D Business Support Center dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Raporti është hartuar duke u bazuar në të dhënat nga sondazhi me ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin e produkteve minerale jo metalike, dhe funksioneve të tyre në Zinxhirin e Vlerës si dhe të dhënat e tjera krahasimore. Mostra e marrë paraqet një pasqyrë të përafërt të dinamikës të tendencave të tregut dhe Zinxhirit të Vlerës, por që nuk pretendon që tërësinë e këtij sektori ta përfaqësoj në përpikëri.

Lista e shkurtesave	
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CARG	Norma e përbërë e rritjes vjetore
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të lirë në Evropën Qendrore
DK	Dogana e Kosovës
EFTA	Marrëveshja për Tregti të lirë në Zvicër
ILASA	Instituti Ndërkombëtar për Analizën e Sistemeve të Aplikuara
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
MF	Ministria e Financave
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MPHI	Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NOX	Oksid i Azotit
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
SNCR	Reduktimi selektiv jo-katalitik
SO2	Dioksid i Squfurit
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
HYRJE	8
METODOLOGJIA	9
KORNIZA E MOSTRËS	10
PASQYRA E INDUSTRIË SË MINERALEVE JO METALIKE NË NIVELIN GLOBAL	11
PASQYRA E INDUSTRIË SË MINERALEVE JO METALIKE NË EVROPË.....	15
PASQYRA E INDUSTRIË SË MINERALEVE JO METALIKE NË RAJON	17
PASQYRA E INDUSTRIË SË MINERALEVE JO METALIKE NË KOSOVË.....	22
ANALIZA E TË DHËNAVE PRIMARE PËR ZINXHIRIN E VLERËS	27
TË GJETURAT LIDHUR ME FURNIZIMIN (nga perspektiva e ndërmarrjeve prodhuese)	28
TË GJETURAT LIDHUR ME FURNIZIMIN (nga perspektiva e ndërmarrjeve furnizuese)	29
ANALIZA E TË DHËNAVE PRIMARE - NDËRMARRJET PRODHUESE.....	32
TREGJET VENDORE DHE ATO EKSPORTUESE - (nga perspektiva e ndërmarrjeve prodhuese)	35
PENGESAT NË PROCESIN E PRODHIMIT DHE EKSPORTIT.....	37
QARKULLIMI I INDUSTRIË SË PRODHIMIT TË PRODUKTEVE JO METALIKE	37
INOVACIONI.....	38
TRANSPORTI.....	39
TREGJET E EKSPORTIT DHE KËRKESAT PËR EKSPORT	41
AMBIENTI BIZNESOR	45
RRJETËZIMI (nga perspektiva e ndërmarrjeve).....	46
RASTE STUDIMI - NDËRMARRJA A DHE NDËRMARRJA B.....	47
RAST STUDIMI: NDËRMARRJA A.....	47
RAST STUDIMI: NDËRMARRJA B	48
KUFIZIMET KRYESORE TË SEKTORIT	49
REKOMANDIMET	51

Lista e figurave

Figura 1. Harta e botës sipas statusit të zhvillimit	11
Figura 2. Shpërndarja e prodhimit në nivel të ekonomive sipas IIASA dhe UNCTAD	12
Figura 3. Prodhimi total i mineraleve industriale nga vendet liderë për vitin 2018	12
Figura 4. Prodhimi i produkteve kryesore minerale jo-metalike në nivel Global (milion metrik ton)	14
Figura 5. Prodhimi i Qeramikës në nivel Global, 2019 (miljardë metra katrorë)	14
Figura 6. Rezervat kryesore minerale të Evropës	15
Figura 7. Tregu kryesor për mineralet industriale në Evropë	16
Figura 8. Prodhimi i gurit gëlqeror ndër vite	19
Figura 9. Prodhimi i Baltës	19
Figura 10. Struktura e ndërmarrjeve sipas regionit	27
Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve sipas veprimtarisë	27
Figura 12. Vendi më i shpeshtë i furnizimit me lëndë të parë	29
Figura 13. Origjina e furnizimit me lëndë të parë për ndërmarrjet furnizuese	30
Figura 14. Sfidat e ndërmarrjeve furnizuese	31
Figura 15. Sfidat nga ndërmarrjet importuese nga perspektiva e furnizuese	32
Figura 16. Produktet e prodhuara nga ndërmarrjet prodhuese	32
Figura 17. Pagat mesatare bruto për sektorin e prodhimit, administrimit dhe shitjes	33
Figura 18. Vështirësitë në gjetjen e stafit të kualifikuar	34
Figura 19. Kuadrot profesionale të kërkuara	34
Figura 20. Kuadro profesionale të cilat nuk janë në dispozicion	34
Figura 21. Sasia e eksportuar ne vitin 2019 dhe 2020	35
Figura 22. Sasia e prodhuar për treg vendor	36
Figura 23. Sfidat për mos shfrytëzimit e kapaciteteve të plota	36
Figura 24. Pengesat që ndikojnë në prodhim cilësor dhe në eksport	37
Figura 25. Investimet në kërkime dhe zhvillime	39
Figura 26. Përqindjet e investimit në inovacion nga qarkullimi vjetor	39
Figura 27. Produktet e reja	39
Figura 28. Kriteret kryesore për bashkëpunim	40
Figura 29. Sfidat në lidhje me transportin e produkteve për eksport	41
Figura 30. Identifikimi i klientëve të rinj	42
Figura 31. Pritshmëritë për eksport ne vitin 2021 dhe 2022	43
Figura 32. Shtysat kryesore për shitje në tregje të eksportit	43
Figura 33. Harta e Zinxhirit të Vlerës për sektorin e produkteve minerale jo metalike	44

Lista e tabelave

Tabela 1. Prodhuesit kryesorë të produkteve minerale jo metalike në nivel Global.....	13
Tabela 2. Shtetet me prodhimin më të madh të mineraleve Industriale (metrik ton).....	16
Tabela 3. Të dhënat për prodhimin, punësimin dhe kontributin financiar në ekonominë Evropiane	17
Tabela 4. Treguesit e prodhimit dhe të ardhurave nga shitja e mineraleve jo metalike për vitin 2018.	17
Tabela 6. Të dhënat për aktivitetet më të zhvilluara në Rajon.....	18
Tabela 5. Mineralet jo metalike të prodhuara në Maqedoninë e Veriut.....	21
Tabela 7. Pasqyrë e përgjithshme e prodhimit të produkteve minerale jo metalike në kontekstin vendor	24
Tabela 8. Pasqyrë e detajuar e prodhimit të produkteve minerale jo metalike në kontekstin vendor.....	24
Tabela 9. Vlera e eksportit për prodhimin e produkteve minerale jo metalike në euro dhe % në vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe vendeve të tjera	25
Tabela 10. Vlera e eksportit për prodhimin e produkteve minerale jo metalike në euro dhe % në vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe vendeve të tjera sipas nën sektorëve.....	25
Tabela 11. Vlera e importit për prodhimin e produkteve minerale jo metalike në euro dhe % në vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe vendeve të tjera	26
Tabela 12. Vlera e importit për prodhimin e produkteve minerale jo metalike në euro dhe % në vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe vendeve të tjera sipas nën sektorëve.....	26
Tabela 13. Lënda e parë e produkteve të prodhuara	28
Tabela 14. Furnizimi me materiale në tregun vendor dhe ndërkombëtar	30
Tabela 15. Vlera mesatare e qarkullimit vjetor sipas të dhënave.	38
Tabela 16. Vlera e qarkullimit për vitin 2019 dhe 2020 sipas të dhënave zyrtare ASK.....	38
Tabela 17. Eksporti sipas sektorit, produktit dhe vendit eksportues.	42

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Minimi i produkteve minerale në nivel global është shumëfishuar në katër dekadat e fundit, nga 9.6 miliardë metrik ton në vitin 1985, kjo vlerë ka arritur në 17.9 miliardë metrik ton qarkullim në vitin 2019¹. Në bazë të kategorive, këto produkte ndahen në produkte minerale metalike dhe jo metalike.

Produktet e prodhuara në kuadër të industrisë së produkteve minerale jo metalike për shkak të vetive të tyre unike në vazhdimësi gjenerojnë përfitim në fusha dhe industri të ndryshme. Ndër nxitësit kryesor të cilët kanë ndikuar në rritjen e kërkesës për minerale jo metalike janë: industria e ndërtimit, për shkak të urbanizmit të shpejtë nëpër vendet në zhvillim si Kina, India, Indonezia dhe Brazili, si dhe diapazoni i gjerë i përdorimit të tyre në sektorë të tjerë, duke përfshirë këtu industrinë e prodhimit dhe industrinë e energjisë.

Industria e sektorit të produkteve minerale jo metalike, si në nivelin vendor dhe në nivelin global, konsiderohet të jetë një ndër industritë e cila ka mjaft potencial zhvillimi. Andaj, duke konsideruar këtë mundësi, nevoja për hulumtimin e gjendjes reale dhe përmirësimit të saj mbetet e pashmangshme. Rrjedhimisht, D&D Business Support Center është mbështetur nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në hulumtimin e sektorit dhe njëkohësisht hartimin e Zinxhirit të Vlerës për produktet minerale jo metalike, i cili ka ndihmuar në identifikimin e strukturës së operimit të ndërmarrjeve, pengesat dhe vështirësitë e tyre.

Të gjeturat nga ky studim janë bazuar në (120) intervistat e realizuara me NVM, të cilat përbëjnë një mostër gjithëpërfshirëse të kësaj industrie dhe (5) intervistat me akterët relevant të cilët mbështesin këtë industri. Në sektorin e produkteve minerale jo metalike në vendin tonë aktualisht operojnë afro 511 ndërmarrje, të cilat numërojnë gjithsej 5,082 të punësuar formal, të dhëna këto të cilat nxjerrin në pah rritjen e numrit të ndërmarrjeve dhe të punësuarve në këtë sektor krahasuar me vitet paraprake. Në vitin 2019 ishin 443 ndërmarrje me gjithsej 4,454 të punësuar, ndërsa në vitin 2018 ishin 478 ndërmarrje me 3,796 të punësuar².

Të njëjtat ndërmarrje arrijnë qarkullimin vjetor për vitin 2020 mbi 281 milion euro, e dhënë kjo e cila po ashtu tregon rezultate pozitive krahasuar me vitin 2019, ku kishte 279 milion euro qarkullim vjetor, ndërsa në vitin 2018 me mbi 195 milion euro qarkullim vjetor. Ndërmarrjet prodhuese, furnizuese dhe transportuese të produkteve minerale jo metalike kryesisht janë të përqendruara në regjionin e Prishtinës, regjionin e Prizrenit, regjionin e Pejës dhe regjionin e Ferizajt.

Përmes hartimit të Zinxhirit të Vlerës për produktet minerale jo metalike, ashtu siç është cekur edhe në pjesën e mësipërme, është bërë identifikimi i strukturës së operimit të këtij sektori, dhe njëkohësisht janë identifikuar vështirësitë dhe pengesat e ndërmarrjeve në punën e tyre, të cilat janë si në vijim: vështirësitë në furnizim me lëndën e parë, pengesat në procesin e eksportit,

¹ Të dhënat botërore të minim, 2021

² Raport - Industria përpunuese, nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, 2021

aftësimi profesional i të punësuarve në prodhim, konsumi i lartë i energjisë elektrike, nevoja për investim në makineri, dhe ndikimi i pandemisë Covid-19.

HYRJE

Republika e Kosovës, për të përmirësuar standardin e jetesës si dhe të ekuilibrojë bilancin tregtar, ka nevojë për një ritëm shumë më të shpejtë të rritjes së prodhimit, eksportit dhe investimeve në industri.

Një nga industritë e cila ndër vite ka dëshmuar një ritëm të shpejt zhvillimi, për arsye të pasurive natyrore, që është nevojë e pashmangshme për përdorimin e produkteve të saja është industria e mineraleve jo metalike.

Republika e Kosovës është e pasur me minerale jo metalike, siç janë magnezi, argjilë e çimentos, kaolini për pllaka, argjila, kuarci, bentoniti, zhavorri, etj. Ndërsa nga kombinimi i tyre prodhohen produkte të përpunuara si qelqi, qeramika, çimento, gëlqerja, llaçi dhe betoni, etj.

Përveç vendit tonë, sektori i produkteve minerale jo metalike është i zhvilluar dhe në gjithë botën, ku konsiderohet si një ndër sektorët premtues të një veprimtarie me qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të lartë.

Vendet apo ekonomitë në zhvillim janë ndër ekonomitë të cilat arrijnë vlera të larta të prodhimit të materialeve jo metalike për vendin e tyre por dhe për eksport, vlera të cilat nxiten drejt-përdrejt nga kërkesa për materiale ndërtimore, duke marrë parasysh trendet e shpejta të urbanizimit në vendet në zhvillim, përcjellur tutje nga ekonomitë e zhvilluara si dhe ato në tranzicion.

Vendet e Bashkimit Evropian konsiderohen të jenë vende me qëndrueshmëri të lartë tregu, kryesisht për prodhimin e qelqit, të nevojshëm për përdorim në sektorin e ndërtimtarisë. Gjermania mbetet prodhuesi më i madh i BE-së me rreth 1/5 e vëllimit, pasuar nga Franca, Spanja dhe Italia³.

Zhvillimi i mëtejshëm i industrisë së produkteve minerale jo metalike, në vazhdimësi ndikon në nivelin e zhvillimit ekonomik në nivel vendor, rritjen e numrit të ndërmarrjeve, rritjen e numrit të të punësuarve dhe vlerën e qarkullimit vjetor.

Sektori i produkteve minerale jo metalike, përveç të punësuarve direkt në këtë sektor, njëkohësisht ka ndikim edhe tek numri i të punësuarve në sektorët të tjerë, të cilët në mënyrë indirekte janë të lidhur me këtë veprimtari.

Ky raport i Zinxhirit të Vlerës paraqet një rëndësi të veçantë në lidhje me sektorin e produkteve minerale jo metalike, pasi që është i pari për këtë sektor dhe ka për qëllim mbështetjen e konkureshmërisë së sektorit.

³ Aleanca e qelqit të Evropës, 2021, “Raporti Statistikor 2020-2021”

Përmes këtij raporti do të identifikohen lidhjet që mungojnë, boshllëqet dhe kufizimet e Zinxhirit të Vlerës. Po ashtu, këto të dhëna do të shfrytëzohen për hartimin e strategjive të reja dhe politikave të ardhshme për këtë sektor.

METODOLOGJIA

Hulumtimi për hartimin e Zinxhirit të Vlerës për sektorin e produkteve minerale jo metalike kryesisht është bazuar në të dhënat primare dhe sekondare, i njëjti është realizuar nga kompania konsulente D&D Business Support Center dhe është financuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ky Zinxhir i Vlerës është punuar me qëllim që Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ti ketë më të qarta të dhënat përkatëse dhe të azhurnuara të këtij sektori përmes të cilave do të mbështeste përcaktimin e masave të politikave të bazuara në prova, të cilat mund të adresojnë në mënyrë efektive lidhjet të cilat mungojnë.

I njëjti, gjithashtu do të shërbejë në identifikimin e produkteve konkurruese ose grupin e produkteve të sektorit për prodhimin e produkteve minerale jo metalike, për përcaktimin e masave adekuate të mbështetjes, për rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm, ku do të ndikojë në stimulimin e rritjes së sektorit, krijimin e vendeve të punës, rritjen e të ardhurave dhe rritjen ekonomike në përgjithësi.

Duke pas parasysh arritjen e këtij qëllimi, për studimin dhe hartimin e Zinxhirit të Vlerës për produktet minerale jo metalike, janë identifikuar akterët relevant të kësaj industrie, si dhe ndërmarrjet prodhuese, furnizuese dhe transportuese për intervistim.

Janë përpiluar pyetësorët përmes të cilëve janë nxjerrë të dhënat primare, të dhëna këto të cilat kanë shërbyer në hartimin e këtij studimi. Pyetësorët e përdorur për intervistimin e akterëve dhe ndërmarrjeve janë ndarë si në vijim:

1. Pyetësori për akterët e sektorit të industrisë për prodhimin e produkteve minerale jo metalike,
2. Pyetësori për ndërmarrjet prodhuese,
3. Pyetësori për ndërmarrjet furnizuese,
4. Pyetësori për ndërmarrjet transportuese.

Të dhënat primare të mbledhura në këtë hulumtim janë bërë përmes vizitave B2B me pronarët e ndërmarrjeve apo njërin nga drejtuesit e lartë, të cilët kanë pasur përvojë të mjaftueshme në aktivitetet e përgjithshme të biznesit.

Gjatë mbledhjes së të dhënave primare pas intervistimit me bizneset, dy ndërmarrje janë konsideruar si raste studimi, për të cilat është kuptuar mbarëvajtja e punës që nga themelimi i ndërmarrjes deri më tani.

Ndërsa, përveç të dhënave primare të cilat janë shfrytëzuar për hartimin e studimit të Zinxhirit të Vlerës, njëkohësisht janë mbledhur të dhënat sekondare të cilat janë përdorur si plotësim dhe

analizë e gjendjes së sektorit të produkteve minerale jo metalike të marra nga institucionet relevante si Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës.

KORNIZA E MOSTRËS

Për hartimin e Zinxhirit të Vlerës, ashtu siç është përmendur në pjesën e mësipërme, janë shfrytëzuar të dhënat primare dhe ato sekondare, ndërsa për të pasqyruar saktë gjendjen e sektorit të industrisë së produkteve minerale jo metalike, fillimisht nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është pranuar një listë e ndërmarrjeve prodhuese të këtij sektori.

Njëkohësisht, nga D&D Business Support Center, janë identifikuar dhe ndërmarrjet furnizuese dhe transportuese të këtij sektori, me qëllim të identifikimit të procesit të operimit të punës që nga fillimi e deri në përfundim të produktit final dhe shitjes së tij.

Vlen të theksohet së përzgjedhja e mostrës është bërë duke përfshirë ndërmarrje nga të gjitha regjionet e Kosovës. Kjo mostër i është përshtatur llojit të veprimtarisë së ndërmarrjeve të intervistuar në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse dhe të pasqyrojë gjendjen reale të sektorit të produkteve minerale jo metalike dhe mënyrën e operimit të punës së tyre.

Pjesë e kësaj mostre të shfrytëzuar për nxjerrjen e të dhënave primare dhe analizimin e tyre të mëtutjeshëm janë konsideruar intervistat me 120 ndërmarrje si numër i përgjithshëm, nga të cilat 84% apo 101 ndërmarrje të cilat funksion kryesor e kanë prodhimin e produkteve minerale jo metalike, 11% apo 13 ndërmarrje të cilat funksion kryesor e kanë furnizimin me produkte minerale jo metalike si dhe pjesa tjetër prej 5% apo 6 ndërmarrje funksion kryesor e kanë transportin e produkteve minerale jo metalike.

Rëndësi të veçantë i është dhënë intervistave të realizuara me 5 akterë relevantë, duke përfshirë këtu edhe kontributin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht departamenti i industrisë, të cilët kanë ndihmuar në pasurimin e këtij studimi me informacione relevante lidhur me sektorin e produkteve minerale jo metalike.

Në vazhdimësi, duke u bazuar në të gjeturat e këtij studimi, është përpiluar edhe Zinxhiri i Vlerës për produktet minerale jo metalike.


PASQYRA E INDUSTRIË SË MINERALEVE JO METALIKE NË NIVELIN GLOBAL

Pandemia e shkaktuar nga Covid-19 në nivel global ndikoi jashtëzakonisht shumë në ndryshime të shpërndarjes dhe në zinxhirët e prodhimit në të gjithë sektorët, ndryshime të cilat rezultuan në pasoja të mëdha ekonomike. Shoqëritë tregtare hasën vështirësi financiare për të vazhduar veprimtarin e tyre dhe për të ruajtur vendet e punës si rezultat i ndërprerjes së aktiviteteve të importit dhe eksportit të produkteve, duke përfshirë edhe produktet minerale jo metalike. Aktualisht, tregjet kanë filluar adaptimin me normalitetin e ri, duke përfshirë këtu edhe industrinë e mineraleve jo metalike.

Madhësia e tregut global të produkteve minerale jo metalike parashikohet të rritet me një normë mesatare të rritjes vjetore (CAGR), të vlerësuar prej 3.8% nga viti 2021 deri 2028⁴. Ngritja do të nxitet nga kërkesa në rritje për materiale ndërtimi për shkak të urbanizimit të shpejtë nëpër vendet në zhvillim si Kina, India, Indonezia dhe Brazili. Paralelisht, ka një ngritje të madhe fokusi të qeverive dhe vendimmarrësve në lidhje me burimet e ripërtrishme të energjisë, si dhe kërkesës për mallra të konsumit me zgjidhje të qëndrueshme paketimi në mbarë botën, marrë parasysh ruajtjen e ambientit.

Interesi për tregun e mineraleve jo metalike është vazhdimisht në rritje, gjë që tregon kushte të favorshme për kërkim, vlerësim dhe zhvillim të depozitave të reja. Për të pasqyruar aktivitetet e sektorit në nivel global, ky studim ka marrë parasysh metodën e klasifikimit të zhvilluar nga Instituti Ndërkombëtar për Analizën e Sistemeve të Aplikuara (IIASA, Austri) dhe Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), që paraqet aktivitet në bazë të ekonomive të zhvilluara, vendet në tranzicion, ekonomitë në zhvillim si dhe vendet me ekonomitë më pak të zhvilluara.

Figura 1. Harta e botës sipas statusit të zhvillimit




Burimi: Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), 2020

⁴ DataIntel, Produktet minerale jometalike në nivel Global, 2020

Shpërndarja e të gjithë prodhimit të mineraleve në botë për vitin 2018 është si në vijim: vendet me ekonomitë më të zhvilluara minuan 27.42% të të gjitha mineraleve, vendet me ekonomi në tranzicion minuan 12.88%, vendet me ekonomitë në zhvillim me 58.57%, dhe vendet me ekonomitë më pak të zhvilluara minuan 1.12% të të gjitha mineraleve.

Figura 2. Shpërndarja e prodhimit në nivel të ekonomive sipas IIASA dhe UNCTAD




Burimi: Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Tregtia dhe Zhvillimi (UNCTAD), 2020

Të ardhurat në prodhimin e produkteve minerale jo metalike parashikohen të arrijnë në 276.10 miliardë dollarë në vitin 2022. Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve në vitin 2018 arriti në 30.539⁵.

Sipas të dhënave, Ekonomitë në zhvillim përbëjnë më shumë se gjysmën e prodhimit të produkteve minerale jo-metalike, si rrjedhojë në nivel shteti; Kina, India, Turqia dhe shtete tjera në zhvillim janë liderë të prodhimit të mineraleve jo-metalike në nivel global, për më shumë detaje, të dhënat janë paraqitur në figurën në vijim.

Figura 3. Prodhimi total i mineraleve industriale nga vendet lidere për vitin 2018



Burimi: Kirsanov, A., K., et al., 2022, "Çështjet e monopolizimit të tregut në nxjerrjen e mineraleve jo metalike në ekonomitë në tranzicion".

Industria e mineraleve jo metalike është e njohur për prodhimin e produkteve të çimentos, qeramikës, qelqit dhe gëlqeres, etj. Gama e aplikimit të këtyre produkteve dhe nënprodukteve të

⁵ Statista, Mar 6, 2022

tyre është mjaft e gjerë, nga materialet e ndërtimit deri tek pajisjet e sanitarisë. Në kontekstin e produkteve minerale jo metalike, me intensitet të madh prodhimi në nivel global kemi pesë (5) produkte kryesore, ndër to janë: rëra dhe zhavorri, çimento, gëlqerja, qelqi dhe qeramika. Vlen të theksohet se shndërrimi i mineraleve jo metalike në këto produkte finale të procesuara është shpesh një proces me energji të intensitetit të lartë dhe i cili mund të përfshijë disa hapa, të tilla si ngrohja, bluarja, përzierja, prerja, formësimi dhe grimcimi.

Tabela në vijim paraqet prodhimin e produkteve minerale jo metalike, në bazë të shteteve si dhe njësive matëse adekuata sipas krahasimeve.

Tabela 1. Prodhuesit kryesorë të produkteve minerale jo metalike në nivel Global

Qeramikë	Kina	India	SHBA
Miliardë metër katrorë	8.47	1.32	0.92
Rërë dhe zhavorr	SHBA	Italia	Franca
Milion metrik ton	72	13.8	8.7
Qelq	Kina	Gjermania	SHBA
Eksporti në (Miliardë dollarë Amerikan)	18.3	6.6	4.9
Gëlqere	Kina	SHBA	India
Milion metrik ton	310	17	16
Bentoniti	SHBA	Kina	Greqia
Milion metrik ton	4.6	3.2	1.3
Çimento	Kina	India	Vietnami
Milion metrik ton	2500	330	100

Burimi: Garside. M., 2022. Statista.


Sipas të dhënave, Kina së bashku me SHBA-në janë ndër liderët kryesorë në nivel global për prodhimin e mineraleve. Kina është prodhuesi më i madh i pllakave qeramike, qelqit, çimentos dhe gëlqeres në mbarë botën, përcjellur nga India me 1.32 miliardë metra katrorë si dhe SHBA-të me 92 milion metër katrorë⁶. Ndërsa, në vitin 2021, për prodhimin e rërës dhe zhavorrit, Shtetet e Bashkuara janë prodhuesit kryesorë në mbarë botën, duke prodhuar 720 milionë metrikë ton, përcjellur nga Italia dhe Franca. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjithashtu, janë liderë në prodhimin e bentonitit me 4.6 milion metrik ton për vitin 2021.

Përpos fuqisë së madhe punëtore, teknike dhe teknologjike, këto vende kanë konsum të lartë në tregun e brendshëm si dhe eksportojnë në vendet tjera për të përmbushur kërkesat e tregut.

Ngjashëm është paraqitur dhe prodhimi i produkteve minerale jo metalike në nivelin global në figurën e mëposhtme.

⁶ Statista, Mar 6, 2022


Figura 4. Prodhimi i produkteve kryesore minerale jo-metalike në nivel Global (milion metrik ton)



Burimi: UN Comtrade

Prodhimi i qeramikës në nivel global, sipas raporteve në vitin 2019 janë prodhuar 12.7 miliardë metra katrorë qeramikë dhe janë përdorur për konsum rreth 12.4 miliardë metra katrorë.

Figura 5. Prodhimi i Qeramikës në nivel Global, 2019 (milyardë metra katrorë)



Burimi: UN Comtrade


Nxjerrja dhe përpunimi i burimeve minerale ka ndikim të konsiderueshëm në tokë, ujë, ajër dhe burime biologjike. Si rrjedhojë, presioni shoqëror është gjithnjë në rritje në lidhje me mjedisin, dhe kjo paraqet një sfidë evidente për sektorin e produkteve minerale jo metalike. Për të trajtuar ndikimin në mjedis është duke u punuar vazhdimisht dhe ekzistojnë plane të veprimit të cilat përfshijnë strategji që synojnë stimulimin e inovacionit brenda sektorëve. Nga ana tjetër, zhvillimet industriale dhe ndikimi i teknologjisë do të vazhdojë të ndikojë dramatisht edhe në industrinë e prodhimit, qoftë në aspektin e automatizimit të makinerisë, digjitalizimit, inteligjencës artificiale apo forma të tjera të avancuara teknologjike.

PASQYRA E INDUSTRISE SË MINERALEVE JO METALIKE NË EVROPË

Industria minerare evropiane ka një traditë të gjatë dhe sot ajo është ndër sektorët industrial më modern dhe më inovativ të kontinentit. Eksplorimi, nxjerrja dhe përfitimi i mineraleve mbështetet nga teknologjitë e nivelit të lartë. Industria, gjithashtu, promovon përparime në fushat e mbrojtjes së mjedisit, shëndetit dhe sigurisë.

Tregu evropian i produkteve minerale jo metalike ka një peshë prej rreth 37% për sa i përket të hyrave. Rajoni pritet të ruajë dominimin e tij edhe në të ardhmen sipas parashikimeve për periudhën 2021 – 2028⁷. Evropa është shtëpia e më shumë se 130 kompanive si pjesë përbërëse e sektorit dhe nën-sektorëve të mineraleve jo metalike. Gjermania dhe Franca janë dy nga tregjet lidere në Evropë, dhe do të vazhdojnë të kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e këtij sektorit gjatë periudhës së parashikimit⁸. Më poshtë është paraqitur një pasqyrë e disa prej produkteve kryesore jo metalike të zhvilluara në vendet evropiane, sipas të dhënave nga Komisioni Evropian.

Figura 6. Rezervat kryesore minerale të Evropës



Burimi: Byroja e Kërkimeve Gjeologjike dhe Minierave

Lëndët e para minerale jo metalike karakterizohen nga shumëllojshmëria e madhe e shkëmbinjve dhe mineraleve. Aplikimi i të gjitha lëndëve të para është mjaft i larmishëm. Në bazë të fushës së aplikimit mund të dallohen dy grupe: lëndët e para agrokimike dhe kimike (plehrat dhe lëndët e para për industrinë kimike) dhe materiale ndërtimi gjeologjike apo industriale.

⁷ Intelto, 2020, “Raporti mbi Tregun e Produkteve Minerale Jo metalike”;

⁸ Ibid

Ndër prodhuesit më të mëdhenj të mineraleve jo metalike ndër vite sipas shteteve në kontinentin Evropian janë paraqitur si në vijim.


Tabela 2. Shtetet me prodhimin më të madh të mineraleve Industriale (metrik ton)

Viti	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjermania									
Potasë	3,214,696	3,149,386	3,075,201	3,126,913	3,056,528	3,056,528	2,906,481	2,754,085	2,615,284
Kaolinë	4,898,516	4,347,591	4,348,562	4,275,422	3,733,714	4,740,000	5,168,000	4,930,000	4,760,000
Kripë	174,424,265	14,445,261	17,389,096	13,330,692	13,957,574	14,335,123	15,567,990	16,248,784	16,627,893
Spanjë									
Gips	7,825,747	6,313,777	7,388,699	7,200,000	7,790,000	8,770,650	9,428,782	9,500,000	10,643,585
Flourspar	109,284	100,000	96,810	120,588	130,647	130,131	125,870	110,000	170,000
Greqia									
Betonit	1,188,442	1,235,105	1,000,000	1,011,485	1,123,320	883,220	1,087,800	1,365,374	1,393,958
Bullgaria									
Abestos	600	600	600	600	600	600	600	600	600
Sllovakia									
Magnezit	1,196,600	1,008,460	933,200	887,500	880,000	683,400	975,100	1,053,900	1,015,800

Burimi: C. Reichl, M. Schatz, *Të dhënat e minierave botërore, Volumi 36, Vjenë, 2021*
(Vërejtje: Rusia nuk është përfshirë në këto të dhëna)

Mineralet jo metalike, qoftë në gjendje të përpunuar apo natyrore, kryesisht përdoren për materiale ndërtimi, qeramikë, detergjente, elektronikë, filtrim, qelq, medikamente dhe pajisje mjekësore, bojëra, letër dhe plastikë, dhe shumë produkte të tjera industriale dhe shtëpiake. Ato, gjithashtu, karakterizohen si të gjithanshme; shumica kanë të paktën dy, ndonjëherë edhe shumë aplikime në sektorë të ndryshme dhe përfshijnë tregje të shumta. Si rrjedhojë, edhe tregu i tyre është mjaft i gjerë.

Figura 7. Tregu kryesor për mineralet industriale në Evropë



Burimi: Raporti vjetor 2022, IMA Evropë

Sipas të dhënave, tregu kryesor për minerale jo-metalike në nivel Evropian është sektori i ndërtimtarisë, që përbën 20% të prodhimit total, pasuar nga sektori për prodhimin e qelqit, qeramikës dhe tullave. Aplikimi i mineraleve me intensitet më të ulët vërehet në sektorin e ushqimit dhe ngjyrave.

Në kontekstin ekonomik, për vitin 2021 janë prodhuar 180 milion ton minerale jo-metalike dhe janë punësuar 42,500 punëtorë duke përfshirë 28 shtete Evropiane. E gjithë kjo ka kontribuar në ekonominë Evropiane me 14 miliardë Euro.

Tabela 3. Të dhënat për prodhimin, punësimin dhe kontributin financiar në ekonominë Evropiane

Prodhimi	Punësimi	Kontributi financiar
180 Milion ton	42,500	14 Miliardë Euro

Burimi: Raporti vjetor 2022, IMA Evropë

Evropa është e pasur me burime natyrore dhe nxjerrja dhe furnizimi me minerale vazhdojnë të luajnë një rol vendimtar në ekonominë dhe mirëqenien ekonomike dhe shoqërore. Aktualisht, Evropa përmbush pothuajse të gjitha kërkesat në prodhimin e shumë mineraleve industriale dhe agregateve për konsum. Megjithatë, vlerat e importit të metaleve dhe xeheve metalike janë të rëndësishme.

PASQYRA E INDUSTRIËS SË MINERALEVE JO METALIKE NË RAJON

Sektori minerar përbën një pjesë të vogël të ekonomive në Ballkanin Perëndimor, megjithatë, duhet theksuar se si sektor është duke shënuar ngritje pozitive nga viti në vit. Një ndër faktorët mund të jetë dinamizmi i sektorit të patundshmërisë, zhvillimi i urbanizmit në përgjithësi në Ballkanin Perëndimor, ku tregu i mineraleve jo metalike parashikohet të ketë një perspektivë pozitive edhe në vitet e ardhshme. Gjithashtu, marrë parasysh presionin dhe nevojën për arritjen e marrëveshjeve për ndërtimin e korridoreve në Ballkan për ngritjen dhe lehtësimin e qarkullimit të mallrave dhe njerëzve, do të nxisë sektorin e ndërtimit, gjë që do të përkthehet indirekt në rritjen e kërkesës për minerale jo metalike.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur indikatorët dhe pjesëmarrja në prodhim të mineraleve jo metalike që përfshinë shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Tabela 4. Treguesit e prodhimit dhe të ardhurave nga shitja e mineraleve jo metalike për vitin 2018.

Shteti	Prodhimi (output) i mineraleve jo metalike (mijë ton)	Pjesa e prodhimit të përgjithshëm të minerale jo metalike BP6 (%)	Të hyrat nga shitja e mineraleve jo metalike (nuk përfshihen diamantet), mln dollarë Amerikan
Shqipëria	134	0.2%	5
Bosnja dhe Hercegovina	1,583	2.5%	185

Maqedonia e Veriut	264	0.4%	5
Serbia	128	0.2%	20
Mali i zi	0	0	0
Kosova	2,366	-	3.55

Burimi: Kirsanov, A., K., et al., 2022, "Çështjet e monopolizimit të tregut në nxjerrjen e mineraleve jo metalike në ekonominë në tranzicion" dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, kalkulimi i autorëve.

Gjithashtu, duke konsideruar këtë analizë, njëkohësisht janë identifikuar dhe aktivitetet në të cilat sektori i produkteve minerale jo metalike është më i zhvilluar duke nxjerrë kështu të dhëna të cilat tregojnë për pozicionimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor në këtë sektor.


Tabela 5. Të dhënat për aktivitetet më të zhvilluara në Rajon

Shteti	Aktivitetet më të zhvilluara në sektorin e produkteve minerale jo metalike
Shqipëria	Prodhimi i tullave dhe tjegullave në argjilë të pjekur Prodhimi i produkteve nga çimento, gëlqerja, llaçi dhe betoni
Bosnja dhe Hercegovina	Prodhimi i produkteve nga qelqi Thyerja e gurit Prodhimi i tullave dhe tjegullave në argjilë të pjekur Produkte rezistuese ndaj zjarrit
Serbia	Prodhimi i produkteve nga qelqi Thyerja e gurit Prodhimi i tullave dhe tjegullave në argjilë të pjekur Produkte rezistuese ndaj zjarrit Prodhimi i produkteve nga qeramika
Maqedonia e Veriut	Prodhimi i produkteve nga çimento, gëlqerja, llaçi dhe betoni Prodhimi i produkteve nga qeramika Prodhimi i produkteve nga çimento, gëlqerja, llaçi dhe betoni
Mali i Zi	Prodhimi i produkteve nga çimento, gëlqerja, llaçi dhe betoni
Kosovë	Prodhimi i produkteve nga çimento, gëlqerja, llaçi dhe betoni Thyerja e gurit Prodhimi i tullave dhe tjegullave në argjilë të pjekur Prodhimi i produkteve nga qelqi

Shqipëria

Duke ju referuar shërbimit gjeologjik shqiptar, përmes kërkimit dhe punimeve gjeologjike dhe studimeve të saj të përgjithshme, ka deklaruar të dhëna për afërsisht 32 lloje të ndryshme shkëmbinjsh dhe minerale industriale jo metalike, të zgjeruara në tërë vendin, në 438 vendburime dhe objekte minerare. Vlerësimet e kryera deri më tani tregojnë rezerva të konsiderueshme dhe me një perspektivë të hapur për këto hapësira, duke garantuar fuqizimin e ekonomisë shqiptare.

Figura 8. Prodhimi i gurit gëlqeror ndër vite




Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Aktualisht, njihen rreth 55 vendburime gëlqerorësh, me rreth 450 milionë m³ rezerva gjeologjike, me një perspektivë të hapur për zgjerim.

Shumë ndërtesa, kolona, statuja dhe relike të zbuluara gjatë kërkimeve arkeologjike dëshmojnë se Shqipëria ka një traditë mijërvjeçare për përpunimin e gurëve dhe përdorimin e gurëve dekorativë. Ndërsa, shkëmbinjtë dhe gurët ranor kanë një përhapje të madhe në 9 lokacione në tërë Shqipërinë. Eksploatimi i tyre ka filluar që në vitin 2005 dhe produkti i tyre është kryesisht në formë blloqesh.

Balta (argjilat) që prodhohen në Shqipëri përdoren për prodhimin e pllakave, pllakave majolikë, tullave, prodhimit artistik dhe prodhimin e çimentos. Duke marrë parasysh zonat e përdorimit dhe karakteristikat cilësore të argjilave, në Shqipëri mund të klasifikohen në 9 lloje argjilat e zbuluara.

Figura 9. Prodhimi i Baltës



Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Deri më tani janë 46 depozita dhe objekte të cilat përmbajnë një sasi rreth 260 milionë ton rezerva gjeologjike. Vendburimet më të rëndësishme janë: Tarabosh dhe Drishtë në Shkodër në rrethin e Fushë-Krujës, Brar dhe Vlorë në rrethin e Tiranës, Shën-Vlash në rrethin e Durrësit, Bradashesh në rrethin e Elbasanit, Virovë në rrethin Lushnje, Qaf Topi në rrethin e Vlorës, etj.

Bosnja dhe Hercegovina

Segmenti i minierave të mineraleve jo metalike është kryesisht i pazhvilluar në krahasim me sektorin e minierave të metaleve në vend. Bosnja dhe Hercegovina ka rezerva të konsiderueshme natyrore të mineraleve jo metalike si: gëlqeror, kripë, argjilë, gurë, zhavorr dhe agregate, rërë dhe gips. Kjo ofron mundësi potenciale për investitorët që janë të gatshëm të investojnë në modernizimin e pajisjeve për nxjerrjen e mineraleve të tilla, të cilat, nga ana tjetër, do të nxisin perspektivat e rritjes së këtij tregu në vitet e ardhshme.

Ndarja sipas llojit të produktit dhe analiza e tregut të mineraleve jo metalike në Bosnje dhe Hercegovinë:

- ✓ Xhami dhe produkte me bazë qelqi,
- ✓ Produkte me bazë guri,
- ✓ Produkte ndërtimi me bazë argjile,
- ✓ Të tjera (produkte zjarrduruese, porcelani dhe qeramike).

Gjatë vitit 2015, qelqi dhe produktet me bazë qelqi, dominuan tregun dhe përbënin një pjesë tregu prej më shumë se 45% të totalit të aksioneve të tregut për sa i përket të ardhurave. Tregu i mineraleve jo metalike në Bosnje dhe Hercegovinë është mesatarisht i fragmentuar, marrë parasysh praninë e prodhuesve vendas dhe ndërkombëtarë. Megjithatë, ka shumë shpërndarës në vend që importojnë produkte të lira nga vende si Kina. Ruajtja e energjisë dhe reduktimi i emetimeve tani janë bërë fokusi kryesor i organizatave në të gjithë globin dhe prodhuesit pritet të adoptojnë teknologji të avancuara dhe më të pastra gjatë periudhës së parashikimit. Prodhuesit konkurrojnë në bazë të çmimit, inovacionit, cilësisë dhe performancës.

Serbia

Serbia ka një treg konkurrues të mineraleve. Industria e mineraleve zë vend të rëndësishëm sa i përket eksporteve, megjithëse industria është shumë e varur nga importi i lëndëve të para dhe produkteve të gatshme minerale jo metalike për t'iu përgjigjur kërkesës së lartë në tregun e brendshëm dhe kërkesave me rritje të qëndrueshme të eksporteve.

Promovimi në mënyrë aktive i industrisë së mineraleve për shkak të potencialit të saj të lartë të rritjes, tregu për mineralet jo metalike parashikohet të ketë një perspektive pozitive gjatë katër viteve të ardhshme. Më shumë se 90% e burimeve minerale mbeten të pa eksploruara dhe kjo është një mundësi e jashtëzakonshme për hyrjet e reja që të zgjerojnë aktivitetet e tyre. Për më tepër, disa politika si Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Minerale në Republikën e Serbisë, deri në vitin 2030 do zbatohen për të promovuar industrinë e mineraleve dhe për të ndihmuar rritjen e tregut. Politika të tjera që promovojnë industrinë e mineraleve në Serbi përfshijnë sigurimin e regjistrimit më të shpejtë për kompanitë, regjistrimin dhe miratimet me një portal të vetëm për kompanitë, përfitimet tatimore si eksportet pa doganë dhe TVSH-në e ulët, dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë me tregjet e eksportit. Gjithashtu, qeveria ka iniciuar projekte të shumta për rritjen e industrisë minerale, të cilat do të krijojnë një mjedis të favorshëm për rritjen dhe përhapjen e tregut të mineraleve jo metalike në vend.

Ndarja sipas llojit të produktit dhe analiza e tregut të mineraleve jo metalike në Serbi:

- ✓ Xhami dhe produkte me bazë qelqi,
- ✓ Produkte me bazë guri,
- ✓ Produkte ndërtimi me bazë argjile,
- ✓ Produkte zjarrduruese,
- ✓ Produkte porcelani dhe qeramike.

Për sa i përket të ardhurave, segmenti i produkteve me bazë të qelqit dhe qelqi, kryesuan tregun e mineraleve jo metalike në Serbi, duke zënë afër 51% të pjesës së tregut. Në Serbi, qelqi dhe produktet me bazë qelqi përdoren në aplikime të tilla si dritaret dhe fasadat e ndërtesave, xhamat e përparme dhe dritaret e automobilave, panelet diellore dhe pajisjet elektrike dhe elektronike. Faktorë të tillë si kostot relativisht të ulëta të energjisë në krahasim me shumicën e vendeve të BE-së dhe prezantimi dhe disponueshmëria e një game të gjerë produktesh do të nxisin perspektivat e rritjes së këtij segmenti të tregut në vitet e ardhshme.

Konkurrenca dhe shitësit kryesorë: tregu i mineraleve jo metalike në Serbi është mjaft i fragmentuar dhe karakterizohet nga prania e shumë prodhuesve dhe shpërndarësve vendas që importojnë produkte me kosto të ulët nga vende si Kina. Përbërja e tregut është heterogjene, e përbërë nga prodhuesi shumëkombësh, ata rajonalë dhe vendas. Prodhuesit konkurrojnë për sa i përket çmimit, inovacionit, cilësisë dhe performancës.

Maqedonia e Veriut

Maqedonia e veriut është një vend i pasur me burime minerale si asbesti, gipsi dhe druri, dhe paraqet potencial për ekonominë e vendit. Në vitin 2017 dhe 2018, prodhimi i produkteve minerale përfaqësuan vetëm një pjesë e vogël e ekonomisë së Maqedonisë së Veriut⁹.

Ndër mineralet jo metalike të prodhuara në Maqedoninë e Veriut janë: gipsi dhe gurët gëlqerorë, ku të dhënat paraqesin një sasi prej 1.5 milion ton të prodhuar për vitin 2020, që njëherit paraqet një nga mineralet jo metalike të vetme, me rritje të prodhimit, krahasuar me vitin paraprak.

Për më shumë detaje, referohuni tek tabela në vijim.

Tabela 6. Mineralet jo metalike të prodhuara në Maqedoninë e Veriut

Produktet	2019 / Meterik ton	2020 / Meterik ton
Mermer dhe gurë të tjerë gëlqerorë dekorativë ose ndërtimorë	102,128	75,181
Granit, gur ranor dhe gurë të tjerë dekorativë ose ndërtimi	15,345	10,349
Gur gëlqeror dhe gips	1,494,401	1,595,273
Rërë natyrale	252,505	239,424
Gurë i grimcuar dhe i bluar, i përdorur për ndërtim	1,076,160	619,820

Burimi: Libri statistikor 2021, Republika e Maqedonisë së Veriut.

⁹ Renaund. M., K., et al., 2020, "Libri vjetor i mineraleve 2017–2018"

Mali i Zi

Boksiti i kuq ndodhet në zonën e Nikshiqit, së bashku me qymyrin ku përfaqësojnë lëndën e parë minerale strategjike në Mal të Zi.

Përveç kësaj, depozitat e zhavorrit dhe rërës janë të bollshme në shtratin e lumit Moraça, afër Podgoricës, në luginën e Limit dhe në rrjedhën e sipërme të lumit Tara. Minierat janë të përqendruara në disa zona në këtë vend të vogël, ku shfrytëzimet e boksitit kanë kryesisht një ndikim vizual në peizazhin natyror. Gjithashtu, gërmimet e zhavorrit dhe rërës janë jo të lehta në jugun e vendit. Në përgjithësi, vendet e Ballkanit Perëndimor, paraqesin potencial të qëndrueshëm në sektorin e mineraleve jo metalike. Marrë parasysh se ekonomitë e tyre janë në tranzicion si dhe traditën e gjatë në këtë sektor, si rrjedhojë kërkesa për konsum është në rritje.

PASQYRA E INDUSTRIË SË MINERALEVE JO METALIKE NË KOSOVË

Pozicionimi i shtetit të Kosovës në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, kushtet natyrore dhe pozita e favorshme gjeografike kanë mundësuar potencial të madh për zhvillimin ekonomik dhe industrial të vendit, ndonëse industria e Kosovës në vitet e 90-ta kishte ngecje të mëdha në zhvillim, prodhim, punësim, eksport, si pasojë e luftës e cila ka ndikuar në rënien thuajse të plotë të sektorëve të industrisë.

Ndër hapat e parë të proceseve drejt zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe integritimeve në institucionet rajonale dhe ndërkombëtare është konsideruar zhvillimi dinamik i sektorit privat në ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM), me theks të veçantë sektori i prodhimit si dhe nismat për privatizim.

Ndër sektorët të cilët janë zhvilluar ndër vite është konsideruar edhe sektori i prodhimit të produkteve minerale jo metalike, ku është vërejtur një rritje e kënaqshme sa i përket numrit të ndërmarrjeve aktive dhe qarkullimit vjetor, gjë e cila ka ndikuar edhe në rritjen e numrit të të punësuarve.

Industria e produkteve minerale jo metalike vazhdon të jetë një ndër industritë më të zhvilluara në vendin tonë, kjo për arsye të pasurive natyrore, siç janë: magnezi, argjilë e çimentos, kaolini për pllaka, argjila, kuarci, bentoniti, zhavorri, etj.

Sipas të dhënave statistikore, në Kosovë kryesisht prodhohen: produkte nga betoni për qëllime ndërtimi, beton i përzier i gatshëm për ndërtim, thyerje e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare, prodhimi i tullave, tjegullave dhe produkteve ndërtimore në argjilë të pjekur, prodhimi i llaçit, formësimi dhe përpunimi i qelqit të rrafshët, etj.

Numri i ndërmarrjeve aktive në sektorin e produkteve minerale jo metalike për vitin 2020 në Kosovë është 511 ndërmarrje, numër ky i cili shënon rritje krahasuar me vitin 2019, në të cilin kanë qenë 443 ndërmarrje, dhe vitin 2018, në të cilin kanë qenë 478 ndërmarrje të produkteve minerale jo metalike.

Të njëjtat ndërmarrje njëkohësisht kanë shënuar rritje edhe në numrin e të punësuarve. Viti 2020 shënon gjithsej 5,082 të punësuar, krahasuar me vitin 2019 ku ishin 4,454 të punësuar, si dhe në vitin 2018 në të cilin janë shënuar gjithsej 3,796 të punësuar në sektorin e produkteve minerale jo metalike.

Ngjashëm si ndryshimet ndër vite për numrin e ndërmarrjeve aktive dhe numrin e të punësuarve, është dhe rritja e qarkullimit vjetor. Në vitin 2020 sektori i produkteve minerale jo metalike ka qenë mbi 281 milion euro qarkullim, në vitin 2019 kishte mbi 279 milion euro, ndërsa në vitin 2018 mbi 195 milion euro qarkullim vjetor, të dhëna këto të cilat dëshmojnë se sektori i industrisë së produkteve minerale jo metalike ka shënuar ndryshime pozitive në ekonominë e vendit¹⁰.

¹⁰ Raport - Industria përpunuese, nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, 2021

Tabela 7. Pasqyrë e përgjithshme e prodhimit të produkteve minerale jo metalike në kontekstin vendor

Kodi	Nën sektori (13) - Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		18	19	20	18	19	20	2018	2019	2020
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	478	443	511	3,796	4,454	5,082	195,005,725.73	279,099,052.93	281,102,702

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga MINT/DI

Tutje në tabelën 4.2, mund të gjeni informacione më të detajuara lidhur me numrin e ndërmarrjeve, numrin e të punësuarve dhe qarkullimin vjetor, duke krahasuar vitet 2020, 2019 dhe 2018 sipas nën aktiviteteve të këtij sektori.

Tabela 8. Pasqyrë e detajuar e prodhimit të produkteve minerale jo metalike në kontekstin vendor

Nën sektori - Prodhimi i produkteve jo metalike (23)	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Prodhimi i produkteve nga qelqi	37	37	42	235	206	229	5,049,226	6,769,087.93	5,957,893.87
Produkte rezistuese ndaj zjarrit	4	3	4	31	37	47	2,528,569	2,794,903.09	2,319,932.40
Prodhimi i produkteve nga qeramika	24	21	27	663	659	677	16,539,453	19,654,990.55	18,667,555.04
Prodhimi i produkteve nga çimento, gëlqerja, llaçi dhe betoni	254	240	274	1915	2536	2940	96,891,747	159,401,685.33	172,374,767.78
Thyerja e gurit	153	136	155	824	849	1008	62,642,303	76,435,214.95	66,905,128.21
Prodhimi i produkteve minerale jo metalike p.k.t	6	6	9	128	166	181	11,354,427	14,043,171.08	14,877,424.78
Gjithsej	478	443	511	3,796	4,454	5,082	195,005,725.73	279,099,052.93	281,102,702.08

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga MINT/DI

Sa i përket eksportit të produkteve minerale jo metalike me vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe vendet tjera, vërehet dukshëm se viti 2020 ka shënuar rritje të vlerës totale të eksportit krahasuar me vlerat e viteve 2019 dhe 2018. Vlera totale e eksportit ka shënuar 9.61 milion euro për vitin 2020, 7.59 milion euro për vitin 2019, ndërsa 7.84 milion euro qarkullim eksporti për vitin 2018. Të dhëna këto të cilat shënojnë rritje për 2.15% krahasuar me vitin paraprak dhe paraqesin përmirësimin e eksportit në sektorin e produkteve minerale jo metalike.

Nga numri i përgjithshëm i 511 ndërmarrjeve aktive të produkteve minerale jo metalike, 21.72% prej tyre janë ndërmarrje eksportuese të produkteve të tyre.

Produktet minerale jo metalike të prodhuara në vendin tonë janë eksportuar kryesisht në Zvicër, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Gjermani dhe Mal të Zi. Ndërsa, vlen të theksohet se viti 2020 ka shënuar rritje eksporti dhe në tregje të reja si në Kroaci, Rumani dhe Republikën e Koresë.

Tabela 9. Vlera e eksportit për prodhimin e produkteve minerale jo metalike në euro dhe % në vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe vendeve të tjera

Kodi	Nën sektori Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	Eksporti			Ndryshimi (2020>2019)	Ndryshimi në % (2020>2019)
		2018	2019	2020		
13	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	7,843,754.76	7,592,128.25	9,613,701.30	2,021,573.05	26.63

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga MINT/DI

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në formë të detajuar të dhënat lidhur me prodhimin e produkteve minerale për eksport, me nën sektorët më me potencial.

Tabela 10. Vlera e eksportit për prodhimin e produkteve minerale jo metalike në euro dhe % në vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe vendeve të tjera sipas nën sektorëve

Kodi	Nën sektori Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	EKSPORTI			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % (2019 -2020)
		2018	2019	2020		
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	7,843,754.76	8,185,416.75	9,613,701.30	1,428,284.25	17.45
23.1	Prodhimi i qelqit dhe produkteve të qelqit	2,014,804.86	2,053,424.25	3,142,013.00	1,088,588.75	53.01
23.2	Prodhimi i produkteve refraktare	62,420.44	3,120.17	8,920.75	5,800.83	185.91
23.3	Prodhimi i materialeve të ndërtimit prej balte	1,191,747.78	1,196,343.86	1,444,113.49	247,769.14	20.71
23.4	Prodhimi i produkteve të tjera prej porcelani dhe qeramike	228,834.41	292,910.47	251,561.68	(41,348.47)	(14.12)
23.5	Prodhimi i çimentos, gëlqeres dhe suvasë	216,210.46	3,733.78	4,,440.20	706.42	18.92
23.6	Prodhimi i artikujve prej betoni, çimentoje dhe suvaje	2,488,881.70	3,145,092.37	2,255,432.06	(889,660.37)	(28.29)
23.7	Prerja, formësimi dhe përfundimi i gurit	1,218,679.94	1,103,888.96	1,090,174.22	(13,714.96)	(1.24)
23.9	Prodhimi i produkteve gërryese dhe produkteve minerale jo metalike	422,175.17	386,902.89	1,417,045.90	1,030,143.11	266.25

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga MINT/DI

Duke pas parasysh rritjen e qarkullimit vjetor për vitin 2020, ngjashëm ka pësuar rritje edhe vlera e importit në vendin tonë.

Sipas të dhënave të pranuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe përpunuar nga Departamenti i Industrisë, vërejmë se viti 2020 kishte 171 milion euro import, krahasuar me vitin 2019 në të cilin kishim 167 milion euro import dhe në vitin 2018 ku kishim 166 milion euro import vjetor.

Tabela 11. Vlera e importit për prodhimin e produkteve minerale jo metalike në euro dhe % në vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe vendeve të tjera

Kodi	Nën sektori Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	IMPORTI			Ndryshimi (2020>2019)	Ndryshimi në % (2020>2019)
		2018	2019	2020		
13	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	166,279,334.09	167,647,853.52	171,245,487.79	3,597,634.27	2.15

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga MINT/DI

Në tabelën e mëposhtme gjeni të dhëna të detajuara për vlerën e importit në vendin tonë sipas nën-aktiviteteve të caktuara nga produktet minerale jo metalike.

Tabela 12. Vlera e importit për prodhimin e produkteve minerale jo metalike në euro dhe % në vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe vendeve të tjera sipas nën sektorëve

Kodi	Nën sektori Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	Importi			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019- 2020
		2018	2019	2020		
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	166,279,334.09	167,647,853.52	171,245,487.79	3,597,634.27	2.15
23.1	Prodhimi i qelqit dhe produkteve të qelqit	29,194,730.28	30,481,637.17	28,285,435.94	(2,196,201.2)	(7.20)
23.2	Prodhimi i produkteve refraktare	2,692,193.05	2,926,526.09	4,160,601.26	1,234,075.17	42.17
23.3	Prodhimi i materialeve të ndërtimit prej balte	53,289,798.56	50,606,094.64	48,897,342.45	(1,708,752.19)	(3.38)
23.4	Prodhimi i produkteve të tjera prej porcelani dhe qeramike	9,360,824.72	8,818,755.63	8,290,976.85	(527,778.78)	(5.98)
23.5	Prodhimi i çimentos, gëlqeres dhe suvasë	44,747,445.31	46,857,549.60	53,892,433.78	7,034,884.18	15.01
23.6	Prodhimi i artikujve prejbetoni, çimentoje dhe suvaje	8,700,035.17	9,376,613.60	11,580,562.74	2,203,949.14	23.50
23.7	Prerja, formësimi dhe përfundimi i gurit	8,648,503.62	6,983,705.80	6,358,725.29	(624,980.51)	(8.95)
23.9	Prodhimi i produkteve gërryese dhe produkteve minerale jo metalike	9,645,803.38	11,596,970.99	9,779,409.48	(1,817,561.51)	(15.67)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga MINT/DI

Sipas këtyre të dhënave, sektori i prodhimit të produkteve minerale jo metalike, sipas analizës në nivelin vendor, tregon se është sektor i cili ka potencial të mëtutjeshëm zhvillimi në numrin e ndërmarrjeve aktive, numrin e të punësuarve dhe po ashtu në vlerën e qarkullimit vjetor.

ANALIZA E TË DHËNAVE PRIMARE PËR ZINXHIRIN E VLERËS

Hartimi i analizës së Zinxhirit të Vlerës për sektorët e industrisë së produkteve minerale jo metalike kryesisht është bazuar në të dhënat primare të gjetura përmes intervistimit të 120 ndërmarrjeve prodhuese, furnizuese dhe transportuese. Ndërsa, vlen të theksohet se përgjatë intervistimit të këtyre ndërmarrjeve kemi kuptuar se disa prej tyre ushtrojnë më shumë se një funksion që nënkupton se një ndërmarrje prodhuese e produkteve minerale jo metalike mund të ushtroj në bazë vetanake funksionin transportues apo furnizues dhe anasjelltas. Gjithashtu, janë realizuar dhe 5 intervista me akterët relevant të këtyre sektorëve, përfshirë institucione të cilat kanë përkrahur këtë sektor.

Me qëllim të pasqyrimin të gjendjes reale të sektorëve të industrisë së produkteve minerale jo metalike, në intervistat e realizuara me ndërmarrje janë shfrytëzuar 4 pyetësorët si në vijim:

1. Pyetësori për akterët e sektorit të industrisë për prodhimin e produkteve minerale jo metalike.
2. Pyetësori për ndërmarrjet prodhuese.
3. Pyetësori për ndërmarrjet furnizuese.
4. Pyetësori për ndërmarrjet transportuese.

Ndërsa, në mënyrë që hulumtimi të jetë sa më gjithëpërfshirës, ndërmarrjet prodhuese, furnizuese dhe transportuese të intervistuar përfshijnë 30 komuna nga Republika e Kosovës, në të cilat sektori i industrisë së produkteve minerale jo metalike janë më të zhvilluara.

Duke u bazuar në numrin e përgjithshëm të 120 intervistave të realizuara për këtë hulumtim, 84% apo 101 janë ndërmarrje prodhuese, 11% apo 13 janë ndërmarrje furnizuese, ndërsa pjesa tjetër 5% apo 6 janë ndërmarrje transportuese të produkteve minerale jo metalike.

Figura 10. Struktura e ndërmarrjeve sipas regjionit





Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve sipas veprimtarisë



TË GJETURAT LIDHUR ME FURNIZIMIN (nga perspektiva e ndërmarrjeve prodhuese)

Përgjatë intervistave të realizuara me ndërmarrjet prodhuese, furnizuese dhe transportuese të sektorit të produkteve minerale jo metalike është kuptuar se disa nga këto ndërmarrje kryejnë më shumë se një funksion të Zinxhirit të Vlerës.

Sipas të gjeturave të këtij hulumtimi, kemi kuptuar se ndërmarrjet prodhuese kanë bashkëpunim me furnizues/importues nga të cilat furnizohen kryesisht me lëndë të parë. Sa i përket mënyrës se si ndërmarrjet prodhuese organizojnë furnizimin e tyre, nga numri i përgjithshëm i të intervistuarve, pjesa më e madhe e tyre apo 90% bashkëpunojnë deri me 3 furnizues/importues, 7% e ndërmarrjeve prodhuese bashkëpunojnë deri me 6 ndërmarrje furnizuese, 2% prej tyre bashkëpunojnë deri në 9 ndërmarrje furnizuese, ndërsa vetëm 1% bashkëpunon me më shumë se 10 kompani furnizuese.

Sa i përket organizimit të transportit të furnizimeve për ndërmarrjet prodhuese, 52% prej tyre e shohin më të favorshëm importin me ndërmjetësues, ndërsa 48% mendojnë se importi është më mirë të organizohet në baza vetanake. Disa nga arsyet bazë që ndërmarrjet e organizojnë transportin me ndërmjetësues janë kostoja, siguria e furnizimit dhe koha.

Në lidhje me furnizimin e produkteve të ndërmarrjeve prodhuese nga furnitorët, 52% e tyre kanë njoftuar që furnizohen me lëndën e parë dhe materiale të nevojshme nga tregu i jashtëm, ndërsa pjesa tjetër apo 48% prej tyre kanë treguar që furnizohen me lëndë të parë ose materiale të nevojshme vetëm nga tregu vendor.

Lëndët e para të cilat përdoren më së shumti nga ndërmarrjet për prodhimin e produkteve të tyre janë: çimento me 24%, guri i pa përpunuar me 22%, zhavorri me 21%, pastaj kemi granitin me 10%, i ndjekur nga qelqi i papërpunuar me 9%, mermeri me 7%, llaçi me 6%, si dhe granulatet 1%.

Tabela 13. Lënda e parë e produkteve të prodhuara


Produktet e prodhuara	Lënda e parë
Produkte nga qelqi	Qelq i papërpunuar
Produkte nga qeramika	Argjila, balta
Produkte nga çimento	Zhavorri, çimento, llaçi, pofix
Produkte nga gëlqerja dhe llaçi	Llaçi për izolim/suvatim, gëlqerja dhe çimento
Produkte nga betoni	Zhavorr dhe çimento
Produkte nga thyerja e gurit	Guri i papërpunuar, mermer dhe granit
Produkte rezistuese ndaj zjarrit	Pluhur i veçantë, pjese anti-zjarr.

Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Rëndësi të veçantë në prodhimin e produkteve jo metalike ka edhe gjeneza e lëndës së parë. Ashtu siç është cekur edhe në pjesën e mësipërme, nga ky studim kemi kuptuar se jo të gjitha

ndërmarrjet prodhuese të produkteve minerale jo metalike importojnë lëndën e parë apo materialet e nevojshme nga tregu ndërkombëtar.

Figura 12. Vendi më i shpeshtë i furnizimit me lëndë të parë



Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të intervistuar, të cilat kanë njoftuar se lënda e parë apo materialet e nevojshme janë të importuara, ku vendi më i shpeshtë për furnizim është nga Shqipëria, e cila përfshin 32% e të intervistuarve, pastaj Turqia me 17%, e ndjekur nga Maqedonia me 15% dhe Kina me 12%. Ndërsa, vendet me përqindje më të ulët të importit janë: Serbia, Greqia, Italia, Spanja, etj.; të cilat përfshijnë 24% nga përqindja totale.

Vlen të theksohet se pandemia Covid-19 ka ndikuar mjaftë shumë në rënie të importit, ndërsa sa i përket sasisë së materialeve apo lëndës së parë e cila është importuar nga ndërmarrjet prodhuese të intervistuar, 12 ndërmarrje kanë importuar materialet e nevojshme në vitin 2019, krahasuar me vitin 2020 ku kishte rënë në 8 ndërmarrje që kanë importuar.

Kostoja e materialeve të nevojshme të cilat përdoren nga ndërmarrjet prodhuese paraqet një sfidë në vete në procesin e furnizimit me lëndë të parë. Sipas të gjeturave nga ky studim 34% e të intervistuarve e kanë theksuar një problem të tillë, kurse 33% të përgjigjeve nga ndërmarrjet prodhuese e konsiderojnë sfidë kohën e furnizimit me lëndë të parë, ndërsa procedurat administrative dhe doganore me 13% të përgjigjeve, pengesat në transport me 12% të intervistuarve dhe po ashtu cilësia e lëndës së parë të importuar e cila është përmendur nga 8% e përgjigjeve të ndërmarrjeve të intervistuar.

TË GJETURAT LIDHUR ME FURNIZIMIN (nga perspektiva e ndërmarrjeve furnizuese)

Me qëllim të përfshirjes të të gjitha funksioneve të Zinxhirit të Vlerës në sektorin e produkteve minerale jo metalike, në këtë studim janë intervistuar ndërmarrje të cilat kanë veprimtari kryesore furnizimin me lëndë të parë apo materiale të nevojshme. Te ndërmarrjet furnizuese janë intervistuar 13 ndërmarrje apo 11% nga numri i përgjithshëm i intervistave të realizuara.

Sa i përket furnizimit, nga gjithsej 13 ndërmarrjet e intervistuar, 8% prej tyre e bëjnë furnizimin me materialet e nevojshme nga tregu vendor, ndërsa nga tregu i jashtëm me 61%, si dhe 31% me materiale furnizohen vetëm nga tregu ndërkombëtar.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur lënda e parë apo materialet me të cilat ndërmarrjet e intervistuar furnizohen kryesisht nga tregu vendor dhe tregu ndërkombëtar apo i jashtëm.

Sipas tabelës të paraqitur me poshtë, materialet kryesore që ndërmarrjet furnizohen nga tregu vendor kryesisht janë: çimento me 44%, guri i papërpunuar me 34% dhe blloqet me 22%.

Ndërsa, në mesin e materialeve apo lëndës së parë të cilat konsiderohen të nevojshme për import, sipas intervistave 56% të ndërmarrjeve kanë deklaruar se kanë nevojë për import të çimentos, 28% guri i papërpunuar, ndërsa 16% produkte finale.


Tabela 14. Furnizimi me materiale në tregun vendor dhe ndërkombëtar

TREGU VENDOR		TREGU NDËRKOMBËTAR	
Çimento	44%	Çimento	56%
Guri i papërpunuar	34%	Guri i papërpunuar	28%
Blloqe	22%	Produkt final	16%
Total	100%	Total	100%

Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Figura 13. Origjina e furnizimit me lëndë të parë për ndërmarrjet furnizuese

Me rëndësi të veçantë për ndërmarrjet furnizuese ka origjina e importeve. Nga ky studim kemi kuptuar që Shqipëria, Gjermania dhe Turqia janë shtetet dominuese të cilat përfaqësojnë nga 23% të furnizimeve nga importi, pastaj kemi Serbinë që përfshin 15% të importeve të ndërmarrjeve të intervistuar si dhe me nga 16% kanë shënuar Kroacia, Italia, Maqedonia e Veriut, etj.



Sa i përket kostove të importit nga vendet e tjera, kostoja e procedurave doganore konsiderohet më e lartë krahas kostove të transportit të cilat cilësohen si mesatarisht të larta.

Shkaqet kryesore të cilat bëjnë që ndërmarrjet të furnizohen nga tregu ndërkombëtar janë përfitimet më optimale. Nga materialet e importuara, 52% e të intervistuarve i konsiderojnë përfitimet më të kënaqshme, ndërsa si përfitim më pak i kënaqshëm konsiderohet ai i tregut vendor me 48%.

Ndërmarrjet e intervistuar janë pyetur gjithashtu lidhur me mënyrën e organizimit të importit për lëndën e parë. Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të intervistuar, 42% e ndërmarrjeve furnizuese të cilat importojnë materiale apo lëndë të parë të nevojshme kanë deklaruar se e kryejnë furnizimin plotësisht në bazë vetanake.


Nga 25% e ndërmarrjeve organizimin e importit e bëjnë pjesërisht në bazë vetanake, 25% e ndërmarrjeve e bëjnë organizimin e importit me ndërmjetësues, ndërsa 8% e tyre e bëjnë organizimin e importit me metodën mix apo sipas nevojës.

Nga të dhënat për deponim, është kuptuar se 69% e ndërmarrjeve organizojnë deponimin plotësisht në bazë vetanake. 23% prej tyre procesin e deponimit e kryejnë pjesërisht në bazë vetanake, ndërsa pjesa tjetër apo 8% e organizon deponimin përmes ndërmjetësuesve.

Përkundër mënyrës së organizimit të importit për lëndën e parë të cilën veç e shfrytëzojnë ndërmarrjet furnizuese të intervistuar, të njëjtat kanë treguar dhe për formën më të përshtatshme për të kryer këtë proces. Përmes të gjeturave nga ky hulumtim, është kuptuar se forma më e përshtatshme për organizim të importit është ajo mikse (sipas nevojës) e cila përfaqëson 50% të ndërmarrjeve, pastaj si formë tjetër e preferuar që përfshin 33% të ndërmarrjeve është konsideruar importi në bazë vetanake, si dhe pjesa tjetër apo 17% e ndërmarrjeve preferojnë organizimin e importit përmes ndërmjetësuesve.

Sfidat që ndërmarrjet furnizuese hasin janë të ndryshme. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa prej sfidave të deklaruara nga ndërmarrjet e intervistuar. Si pengesë më e lartë e ndërmarrjeve furnizuese konsiderohet korniza institucionale dhe shërbimet ligjore dhe legjislative, pasuar nga madhësia e porosisë, transporti, cilësia e lëndës së parë, etj.


Figura 14. Sfidat e ndërmarrjeve furnizuese.



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Ndërsa, sa i përket pengesave të ndërmarrjeve importuese të cilësuar nga ndërmarrjet furnizuese, si pengesa më të theksuara janë konsideruar po ashtu korniza institucionale dhe shërbimet ligjore dhe legjislative, standardet/certifikatat e kërkuara të lëndës së parë, madhësia e porosisë, etj. Ndërsa, të dhëna më të detajuara lidhur me pengesat e ndërmarrjeve importuese nga perspektiva e furnizuesve janë të paraqitura në figurën 11.

Figura 15. Sfidat nga ndërmarrjet importuese nga perspektiva e furnizuese




Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

ANALIZA E TË DHËNAVE PRIMARE - NDËRMARRJET PRODHUESE

Studimi i Zinxhirit të Vlerës për produktet minerale jo metalike nga numri i përgjithshëm i intervistave të realizuara, përfshin 84% apo 101 ndërmarrje prodhuese, të cilat sipas veprimtarisë që ushtrojnë ndahen në sektorët e prodhimit si në vijim: produkte të prodhuara nga betoni 31% e ndërmarrjeve, produkte nga thyerja (përpunimi) i gurit 24%, produkte nga qelqi 12% e ndërmarrjeve, prodhimi i produkteve nga çimento e cila përbën 13% të ndërmarrjeve, produkte nga gëlqerja dhe llaçi me 11% të prodhimit, prodhimi i produkteve nga qeramika që përfshin 7% të ndërmarrjeve, si dhe prodhimi i produkteve rezistuese ndaj zjarrit që përfaqëson 2% të ndërmarrjeve prodhuese të intervistuar për këtë hulumtim.

Figura 16. Produktet e prodhuara nga ndërmarrjet prodhuese



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve


Si pjesë e këtij hulumtimi, rëndësi e veçantë i është dhënë edhe të punësuarve në këto ndërmarrje. Nga ky hulumtim është vërejtur se numri më i lartë i të punësuarve janë në sektorin e prodhimit, duke e konsideruar si procesin kryesor të operimit të këtyre ndërmarrjeve. Ndërsa, pjesa tjetër e të punësuarve janë të orientuar në sektorin e shitjes dhe administratës, që e karakterizon një numër shumë më të vogël krahas sektorit paraprak. Sa i përket gjinisë, në këtë veprimtari pjesa më e madhe e punonjësve i përket gjinisë mashkullore, me moshë mesatare 26-45 vjeç, të cilët kryesisht kanë të përfunduar shkollimin e mesëm.

Sipas studimit të Zinxhirit të Vlerës për produktet minerale jo metalike janë paraqitur të dhëna lidhur me pagën mesatare bruto në tre sektorët: sektorin e prodhimit, e shitjes dhe të administratës. Tek sektori i prodhimit nga përgjigjet e pranuar, 52% e ndërmarrjeve të intervistuar kanë deklaruar se paga mesatare bruto dominuese është 650-740 euro, 17% kanë deklaruar pagën mesatare bruto për të punësuarit në sektorin e prodhimit 450-540 euro, 14% e ndërmarrjeve kanë shprehur se paga mesatare bruto për sektorin e prodhimit është 350-440 euro, 8% kanë shprehur vlerën 550-640 euro pagë mesatare bruto, 5% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se paguajnë më shumë se 740 euro pagë mesatare bruto, 3% paguajnë me pagën mesatare bruto 250-340 euro ndërsa pjesa tjetër që përfshin 1% të ndërmarrjeve prodhuese paguan punonjësit në sektorin e prodhimit me 170-240 euro.

Në sektorin e administratës, 61% e ndërmarrjeve prodhuese të produkteve minerale jo metalike paguajnë stafin me pagë mesatare bruto 250-340 euro, 23% paguajnë stafin e administratës me 350-440 euro, 6% e ndërmarrjeve prodhuese paguajnë stafin me pagë bruto mesatare 170-240 euro, 6% paguajnë 450-540 euro si pjesa tjetër apo 4% paguajnë me 550-640 euro pagë mesatare bruto.

Sa i përket sektorit të shitjes, 56% e ndërmarrjeve prodhuese paguajnë stafin e shitjes me 250-340 euro pagë mesatare bruto, 23% e ndërmarrjeve paguajnë stafin me 350-440 euro, 14% e ndërmarrjeve prodhuese paguajnë punonjësit me pagë bruto mesatare 170-240 euro, 5% paguajnë 550-640 euro, 1% i paguan 450-540 euro si dhe 1% paguajnë pagën mesatare bruto 650-740 euro.


Figura 17. Pagat mesatare bruto për sektorin e prodhimit, administrimit dhe shitjes



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Njëra ndër sfidat më dominuese e këtyre ndërmarrjeve është gjetja e stafit të kualifikuar me njohuri dhe me përvojën e kërkuar profesionale. Nga ndërmarrjet e intervistuar, 71% prej tyre kanë shprehur se kanë shumë vështirësi në gjetjen e stafit të kualifikuar, 25% nga ndërmarrjet e kanë cilësuar si sfidë me pak vështirësi, ndërsa vetëm 4% prej tyre kanë treguar se nuk kanë vështirësi në gjetjen e stafit të kualifikuar.

Figura 18. Vështirësitë në gjetjen e stafit të kualifikuar



Ashtu siç është përmendur në pjesën e mësipërme, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve e kanë cilësuar sfidë të vështirë gjetjen e stafit të kualifikuar, ku si arsye kanë qenë: emigrimi por edhe mungesa e njohurive apo aftësive në fusha të caktuara, ku në mungesë të tyre ndërmarrjet detyrohen t'i kërkojnë këto kadro edhe nga vendet e tjera. Edhe pse këto ndërmarrje mundësojnë trajnime dhe punë praktike në këto fusha për aftësim profesional në procesin e prodhimit, ende vazhdon të ketë mungesë të interesimit të fuqisë punëtore.

Disa nga kuadrot profesionale më të kërkuara dhe të nevojshme për ndërmarrjet prodhuese të produkteve minerale jo metalike janë në sektorin e prodhimit, ku 90% e ndërmarrjeve të intervistuar kanë shprehur se kanë nevojë për kadro më profesionale në procesin e prodhimit, si kadro të kërkuara janë dhe shitja dhe administrata që përfaqësohen me nga 5% nga ndërmarrjet e intervistuar. Sa i përket kuadrove profesionale të cilat në vendin tonë nuk i kemi në dispozicion në tregun vendor më dominante janë inovacioni me 47%, hulumtimi dhe zhvillimi me 42%, prodhimi me 6% si dhe të tjerat më pak të theksuara janë dizajni, shitja, administrata.

Figura 19. Kuadrot profesionale të kërkuara





Figura 20. Kuadro profesionale të cilat nuk janë në dispozicion



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve


Niveli i punonjësve në aspektin profesional në sektorin e produkteve minerale jo metalike luan një rol mjaft të rëndësishëm në procesin e operimit dhe mbarëvajtjes së këtyre ndërmarrjeve.

Andaj duke konsideruar këtë fakt, ndërmarrjet prodhuese në vazhdimësi kërkojnë mbajtjen e trajnimeve të cilat do të përmirësonin aktivitetin e ndërmarrjeve dhe njëkohësisht procesin e eksportit. Ndër fushat për të cilat është përmendur nevoja për trajnime janë: 32% e ndërmarrjeve prodhuese kanë nevojë për trajnim për inovacion, 26% trajnime për hulumtim dhe zhvillim, 20% për përdorimin e teknologjisë, 10% trajnime për prodhim, ndërsa në përqindje më të ulët kërkojnë trajnimet për rrjetëzim dhe tregje të reja, nga 12% trajnim në menaxhim dhe marketing, nga gjithsej përgjigjet e ndërmarrjeve të intervistuar.

TREGJET VENDORE DHE ATO EKSPORTUESE - (nga perspektiva e ndërmarrjeve prodhuese)

Krahas studimit të Zinxhirit të Vlerës është bërë krahasimi i eksporteve të ndërmarrjeve prodhuese ndërmjet dy viteve, vitit 2019 dhe vitit 2020, ndonëse, jo të gjitha ndërmarrjet prodhuese të cilat bëjnë eksport të produkteve të tyre kanë pranuar të deklarohen në lidhje me sasinë që eksportojnë. Nga të dhënat e pranuar, shohim që në vitin 2020 ka një rënie të dukshme në eksport, ku si arsye më të theksuara të kësaj rënie është konsideruar ndërprerja e punës gjatë pandemisë Covid-19 si dhe kostot e larta të transportit.


Figura 21. Sasia e eksportuar ne vitin 2019 dhe 2020



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Nga ana tjetër, edhe te sasia e prodhuar nga ndërmarrja për treg vendor është vërejtur një rënie krahas dy viteve 2019 dhe 2020, e cila gjithashtu është arsyetuar si pasojë e pandemisë Covid-19.

Figura 22. Sasia e prodhuar për treg vendor




Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve të ndërmarrjeve prodhuese është klasifikuar me përqindje, ku 21% prej tyre kanë deklaruar se shfrytëzojnë vetëm deri 50% të kapaciteteve si ndërmarrje, 74% prej tyre kanë njoftuar që shfrytëzojnë deri 80% të kapacitetit, ndërsa pjesa tjetër apo 5% kanë shprehur se shfrytëzojnë deri 100% të kapacitetit si ndërmarrje prodhuese.

Duke u bazuar në të dhënat për shfrytëzimin e kapaciteteve, si rezultat që nga pjesa më e madhe nuk shfrytëzohen kapacitetet e plota, nga ndërmarrjet prodhuese janë definuar edhe disa shkaktarë të kësaj gjendje. Si arsye primare janë mundësitë e tregut në të cilën përfshihet kërkesa e tregut për përpunimin e produkteve, e cila përfaqëson 36% të përgjigjeve të ndërmarrjeve prodhuese. Si sfidë e dytë është cilësuar konkurrenca, e cila paraqet 21% prej tyre, e ndjekur nga mungesa e njohurive të tregut me 13% si dhe mungesa e punëtorëve e cilësuar si sfidë për mos shfrytëzimin e kapaciteteve të plota nga 10% e ndërmarrjeve prodhuese, etj.

Figura 23. Sfidat për mos shfrytëzimit të kapaciteteve të plota




Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

PENGESAT NË PROCESIN E PRODHIMIT DHE EKSPORTIT

Sa i përket eksportit në Kosovë, ekziston një deficit tregtar mjaft i theksuar i cili pasqyron një nivel të ulët të konkurrencës në tregun vendor dhe ndërkombëtar, duke rezultuar me mungesën e shumë llojeve të produkteve.

Studimi paraqet të dhëna nga secila prej ndërmarrjeve prodhuese që kanë treguar se cilat janë pengesat që ndikojnë në prodhim cilësor dhe në eksport. Sipas tyre, pengesë primare është klasifikuar legjislacioni që përfaqëson 31% të ndërmarrjeve prodhuese. Duhet të theksohet që eksportuesit vendor përballen me sfida të brendshme në eksportimin e mallrave të tyre, procedura burokratike që e bëjnë prodhimin dhe eksportimin më të vështirë dhe më të kushtueshëm. Si sfidë e dytë është klasifikuar kostoja me 25%, mjedisi i favorshëm i biznesit që paraqet 14% të ndërmarrjeve prodhuese, ndërsa me 9% për shkak të nivelit më të dobët të prodhimit. Mund të themi se ndërmarrjet prodhuese në Kosovë e kanë më të vështirë të jenë konkurrues jashtë tregut vendor, në një gamë më të gjerë të produkteve, etj.

Figura 24. Pengesat që ndikojnë në prodhim cilësor dhe në eksport



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

QARKULLIMI I INDUSTRIË SË PRODHIMIT TË PRODUKTEVE JO METALIKE

Të dhënat lidhur me vlerën mesatare të qarkullimit vjetor nga ndërmarrjet e produkteve minerale jo metalike janë nxjerrë nga intervistat e realizuara dhe të dhënat e pranuar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Këto të dhëna janë analizuar duke krahasuar vitet 2019 dhe 2020. Sa i përket të dhënave nga ndërmarrjet e intervistuar vërejmë se nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve, jo të gjitha kanë deklaruar qarkullimin e tyre. Bazuar në të dhënat e pranuar nga intervistat e realizuara, vlera mesatare e qarkullimit për tregun vendor në vitin 2020 ka qenë mbi 15 milion euro krahasuar me vitin paraprak, ku vërehet një rënie në vitin 2019 me vlerë të qarkullimit që ishte mbi 17 milion euro. Në vitin 2019, nga ndërmarrjet e intervistuar janë deklaruar mbi 2 milion euro qarkullim në eksport, ndërsa në vitin 2020 janë deklaruar mbi 1 milion euro për eksport si vlerë mesatare e qarkullimit vjetor nga ndërmarrjet prodhuese.

Tabela 15. Vlera mesatare e qarkullimit vjetor sipas të dhënave.

Vlera mesatare e qarkullimit vjetor e ndërmarrjeve të intervistuar	Viti 2019	Viti 2020
Tregu vendor	17,096,470	15,389,485
Eksport	2,588,550	1,783,400
Total	19,685,020	17,172,885

Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Ndërsa, përkundër të dhënave të pranuar nga ndërmarrjet e intervistuar, të dhënat e marra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës lidhur me tregun vendor dhe eksportin në nivel vendi tregojnë rritje krahas vitit 2019 dhe vitit 2020.

Sipas këtyre të dhënave, është kuptuar se për vitin 2019 janë arritur mbi 270 milion euro qarkullim për tregun vendor, ndërsa për vitin 2020 qarkullimi i tregut vendor ka arritur vlerën mbi 271 milion euro. Sa i përket eksportit, për vitin 2019 janë shënuar mbi 8 milion euro eksport, ndërsa në vitin 2020 janë shënuar mbi 9 milion euro eksport.

Tabela 16. Vlera e qarkullimit për vitin 2019 dhe 2020 sipas të dhënave zyrtare ASK

Vlera mesatare e qarkullimit vjetor	Viti 2019	Viti 2020
Tregu vendor	270,913,636.18	271,489,000.78
Eksport	8,185,416.75	9,613,701.30
Total	279,099,052.93	281,102,702.08

Burimi: ASK dhe DPI/MINT

INOVACIONI

Në 3 vitet e fundit 6% të ndërmarrjeve prodhuese kanë bërë investime në kërkime, zhvillime ose aktivitete të lidhura me inovacionin për prodhimin e produkteve të reja ose linjave të prodhimit, ndërsa pjesa tjetër prej 94% kanë mohuar që kanë bërë ndonjë investim në fushën e inovacionit.

Nga 6% e ndërmarrjeve që kanë investuar në hulumtim dhe zhvillim, 66% prej tyre e kanë investuar në H&ZH 10% të qarkullimit vjetor, 17% nga ndërmarrjet kanë përdorur deri në 7% të qarkullimit vjetor në hulumtim & zhvillim dhe 17% prej tyre kanë investuar vetëm 1% të qarkullimit vjetor.

Figura 25. Investimet në kërkime dhe zhvillime





Figura 26. Përqindjet e investimit në inovacion nga qarkullimi vjetor




Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Nga ndërmarrjet të cilat kanë investuar në produkte apo shërbime të reja, është kuptuar se nga 50% prej tyre konsiderohen të reja për tregun, që nënkupton se këto produkte nuk kanë ekzistuar më herët, ndërsa pjesa tjetër apo 50% kanë deklaruar se produktet e tyre konsiderohen ekzistuese për tregun ndërsa janë të reja për ndërmarrjen.

Ndërmarrjet të cilat kanë shtuar produkte apo shërbime të reja, kanë njoftuar se investimet në kërkime, zhvillime ose aktivitete të lidhura me inovacionin janë bërë vetëm nga ndërmarrja pa ndonjë bashkëpunim me partner të jashtëm.

Figura 27. Produktet e reja



Ndërmarrjet e produkteve minerale jo metalike në vazhdimësi shprehin bashkëpunim ndërmjet tyre i cili konsiderohet shpresëdhënës për një mbarëvajtje më të mirë të procesit të punës. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve që deklarojnë bashkëpunim, është ai me ndërmarrje mikro me 50%, e ndjekur nga 38% prej tyre që bashkëpunojnë me ndërmarrje të vogla. Bashkëpunimi me ndërmarrje të mesme përfaqëson 9% prej tyre si dhe 3% janë deklaruar që bashkëpunojnë me ndërmarrje të mëdha.


TRANSPORTI

Studimi i Zinxhirit të Vlerës përmban të dhëna të transportit dhe nga këndi i ndërmarrjeve transportuese, të cilët përfaqësojnë 5% të mostrës totale në këtë hulumtim.

Të dhënat e këtij hulumtimi tregojnë forma të ndryshme për organizimin e transportit siç janë organizimi i transportit në baza vetanake, organizimi i transportit me ndonjë ndërmjetësues si dhe ndërmarrjet që i shfrytëzojnë të dy këto forma të aranzhimit të transporteve.

Nga ndërmarrjet prodhuese të cilat janë intervistuar, 61% prej tyre janë deklaruar se transportin e produkteve e organizojnë në baza vetanake, 20% kanë treguar se aranzhimet e transportit i bëjnë vetëm me ndërmjetësues, 13% kanë thënë se përdorin të dy format për organizimin e transportit të tyre, si dhe 6% kanë thënë që nuk bëjnë fare transport. Sa i përket ndërmarrjeve furnizuese të intervistuar në organizimin e transportit, 67% prej tyre janë deklaruar se transportin e organizojnë plotësisht në baza vetanake, 25% kanë deklaruar se transportin e kryejnë përmes ndërmjetësuesve si dhe 8% kanë thënë se përdorin të dy format e organizimit të transportit sipas nevojës.

Figura 28. Kriteret kryesore për bashkëpunim



Ndërmarrjet të cilat bëjnë transportin e produkteve të tyre kanë përmendur disa nga kriteret kryesore që duhet të plotësohen, në mënyrë që të ketë bashkëpunim: kosto e transportit, kosto e furnizimit, besueshmëria, transparenca dhe kualiteti.


Në lidhje me kostot e transportit, 67% e ndërmarrjeve totale të intervistuar kanë njoftuar se transporti i mallrave në vendet fqinje është deri në 1,000 euro për 20 tonë, ndërsa 33% kanë treguar se kostot e tyre për transportin e mallrave janë nga 1,000 deri në 2,000 euro për deri në 30 tonë.

Gjithashtu, gjatë intervistimit, rreth kostove të transportit të mallrave me vende të tjera, 33% kanë deklaruar që këto kosto variojnë deri në 1,000 euro për 10 tonë, 33% kanë thënë se këto kosto variojnë nga 1,000 deri në 2,000 euro për deri në 20 tonë, ndonëse kjo vlerë e sasisë arsyetohet dhe me distancë të ndryshme midis vendeve të destinuara ndërsa pjesa tjetër prej 33% kanë njoftuar se bëjnë transport vetëm brenda tregut vendor.

Nga qarkullimi i përgjithshëm i ndërmarrjes, kostoja mesatare e transportit llogaritet deri në 9% të vlerës totale për 83% të ndërmarrjeve të intervistuar, një pjesë tjetër prej 14% e ndërmarrjeve kanë treguar se kostoja mesatare që shpenzojnë në transport është deri në 19% e qarkullimit vjetor, kurse deri në 39% të qarkullimit vjetor kanë deklaruar si kosto mesatare të transportit 3% e ndërmarrjeve të intervistuar.

Gjithashtu, janë identifikuar disa sfida në lidhje me transportin e produkteve për eksport, të cilat ndërmarrjet i kanë cilësuar më kryesore. Pengesa e parë e klasifikuar si e tillë nga 56% e ndërmarrjeve është kostoja e transportit, si barrierë sekondare janë procedurat e eksportit me 31% të ndërmarrjeve si dhe sfidë tjetër nga ndërmarrjet janë cilësuar ofruesit e limituar që e specializojnë këtë fushë të shërbimit me 14% të të intervistuarve në total.

Figura 29. Sfidat në lidhje me transportin e produkteve për eksport



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

TREGJET E EKSPORTIT DHE KËRKESAT PËR EKSPORT

Krahas studimit për Zinxhirin e Vlerës është bërë analiza e eksportit të ndërmarrjeve prodhuese të tregut vendor. Nga ky studim nga të gjitha ndërmarrjet prodhuese që janë intervistuar, 26% prej tyre janë deklaruar që i dërgojnë mallrat e tyre në tregun ndërkombëtar. Eksporti i këtyre ndërmarrjeve ka fokus më të lartë në vendet evropiane, specifikisht vendi ku tregtohet më shumë është Gjermania. Nga ana tjetër, 74% prej tyre janë deklaruar që nuk eksportojnë jashtë vendit, edhe pse kanë interesim për eksport.

Për realizimin e eksportit janë disa dokumente bazë që kërkohen:


- Deklarata doganore e mallrave;
- Fatura komerciale;
- Certifikata e origjinës së mallit;
- Për mallra strategjike kërkohet një certifikatë;

Disa nga dokumentet/certifikatat që kërkohen për eksport të cekura nga ndërmarrjet prodhuese janë:

- Fatura komerciale;
- Certifikata e origjinës së mallit;
- Përshkrimi i cilësisë, ISO – Standardet;
 - ISO 23936 - përshkruan parimet e përgjithshme dhe jep kërkesa dhe rekomandime për përzgjedhjen dhe kualifikimin e materialeve jo metalike për shërbim në pajisjet e përdorura në mjediset e prodhimit të naftës dhe gazit, ku dështimi i pajisjeve të tilla mund të përbëjë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e publikut dhe personelit.
- Deklarata për mallrat që nuk janë të dëmshme për mjedisin dhe kafshët.

Ndër punët e pandërprera të ndërmarrjeve e cila lidhet direkt edhe me suksesin e tyre është identifikimi i klientëve të rinj, ndërsa duke u bazuar në përgjigjet e tyre për gjetjen e klientëve të rinj ata përdorin disa forma. 52% e ndërmarrjeve të intervistuar përdorin hulumtimin e tregut për identifikimin e klientëve të rinj, 28% prej panairove dhe 8% përmes diasporës etj.

Figura 30. Identifikimi i klientëve të rinj



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Orientimi i eksportit të ndërmarrjeve prodhuese është më shumë nga vendet evropiane, kryesisht në Gjermani, që përbën 30% të eksporteve të këtyre ndërmarrjeve, si dhe 24% të eksporteve janë në Zvicër. Me përqindje më të vogël janë në Austri, Francë, Belgjikë, etj., që përfshijnë 13% në total. Ndërsa, sa i përket vendeve ballkanike, kryesisht eksportohet në Shqipëri me 13% të ndërmarrjeve, Maqedoninë e Veriut me 9% të ndërmarrjeve, Serbi me 4% të ndërmarrjeve dhe Mal të Zi me 7% të ndërmarrjeve. Ndër arsyet kryesore që eksportojnë në vendet e rajonit është kostoja e transportit, të cilat varen edhe nga largësia e eksportit të mallit.

Disa nga dokumentet e kërkuara për realizim të eksportit janë: deklarata doganore e mallrave, fatura komerciale, certifikata e origjinës, për mallra strategjik kërkohet certifikatë e veçantë, përshkrimi i cilësisë, specifikisht për produktet jo metalike është standardi ISO 23936, si dhe deklarata për mallrat që nuk janë të dëmshme për mjedisin dhe kafshët etj.


Tabela 17. Eksporti sipas sektorit, produktit dhe vendit eksportues.

Sektori	Produktet e eksportuara	Vendet kryesore për eksport	Arsyeja e suksesit	Certifikatat
Produkte jo metalike	Produkte nga betoni, Produkte të çimentos, Produkte nga qelqi, Produkte nga thyerja e gurit, etj.	Gjermani, Zvicër, Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Austri, etj.	Cilësia dhe kosto	Standardi ISO 23936, si dhe deklarata për mallrat që nuk janë të dëmshme për mjedisin dhe kafshët.

Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Pritjet e ndërmarrjeve në lidhje me eksportin për vitin 2022 janë pozitive, ku 96% e ndërmarrjeve planifikojnë të kenë rritje në eksporte, ndërsa 4% nuk presin ndryshime në këtë aspekt.


Figura 31. Pritshmëritë për eksport në vitin 2021 dhe 2022



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve


Arsyet kryesore për qasje më të lehtë në eksport, ku 53% të ndërmarrjeve të intervistuar vlerësojnë qasjen në tregjet e reja, 38% çmime më të favorshme, si dhe 10% e ndërmarrjeve kanë deklaruar që si arsye e kanë diversifikimin e tregut.

Figura 32. Shtysat kryesore për shitje në tregje të eksportit



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Figura 33. Harta e Zinxhirit të Vlerës për sektorin e produkteve minerale jo metalike



AMBIENTI BIZNESOR

Dispozita ligjore e cila ndikon në sektorin e industrisë së produkteve minerale jo metalike, rregullohet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve sipas të cilave operon dhe Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është përgjegjëse për zhvillim të politikave të lidhura me sektorin industrial, nxitjen e rritjes së sektorëve privat, me fokus në NVM dhe promovimin e politikave që përmirësojnë mjedisin e biznesit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është institucioni përgjegjës për çështjet mjedisore. Ndërsa, duke pas parasysh presionin shoqëror dhe atë institucional, njëkohësisht dhe vetëdijesimin social në përgjithësi, zhvillimi i praktikave biznesore duhet të adaptohet me kërkesat aktuale në lidhje me mbrojtjen e mjedisit. Produktet minerale jo metalike luajnë një rol të rëndësishëm të cilin duhet ndjekur në përmirësimin e ndotjes së përgjithshme të ambientit.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë institucionet ligjore përgjegjëse për politikat dhe taksat fiskale. Është e rëndësishme të përmendet se politika fiskale në Kosovë bazohet në praktikën e mira të BE-së. Dogana e Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e rregulloreve doganore, veçanërisht për mbledhjen e detyrimeve doganore si dhe përshkrimin e tregtisë dhe mbrojtjes së markave tregtare dhe të tjerave. Meqenëse Kosova vepron sipas marrëveshjeve të CEFTA-së dhe integritit aspirues në BE, Dogana e Kosovës vepron në përputhje me standardet e saj.

Ngjashëm, si në politikat dhe taksat fiskale, në Republikën e Kosovës ekziston edhe ligji i produkteve të ndërtimit, i cili po ashtu është krijuar duke u bazuar në dispozitat ligjore përkatëse të rregullores së Parlamentit Evropian Nr.305/2011/EU. Kjo rregullore përcakton kushtet për vendosjen në dispozicion të tregut të produkteve të ndërtimit duke përfshirë këtu përdorimin e shenjë CE, e cila vendoset në rastet kur vendi i destinacionit të një produkti e kërkon një gjë të tillë. Ajo mund të aplikohet edhe për produktet në tregun e Kosovës dhe përdorimi i shenjë së konfirmimit të cila aplikohet në rastet kur prodhuesi përmbush kërkesat për vendosjen e saj apo shenjë tjetër ekuivalente të konformitetit sipas marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare.

Sa i përket riciklimit të produkteve minerale jo metalike, disa prej tyre janë të tilla të cilat paraqesin edhe një të ardhme pozitive sa i përket këtij sektori, duke u bazuar edhe në rritjen e përditshme të vetëdijesimit njerëzor mbi riciklimin, përdorimin dhe ndikimin e këtyre produkteve mbi ambientin. Shembull konkret e kemi rritjen e përdorimit të qelqit si rezultat i mundësisë më të madhe për riciklim se sa produktet e tjera, e cila është pozitive edhe mbi ekonominë të cilat kanë përdorim më të gjerë të qelqit në këtë rast si produkt. Në të kundërt, në qoftë se nuk ka kujdes mbi këto produkte dhe hidhen përsëri pa asnjë identifikim, trajtimi jo i duhur do të shkaktojë ndotje mjedisore.

RRJETËZIMI (nga perspektiva e ndërmarrjeve)

Ndërmarrjet prodhuese, furnizuese dhe transportuese të produkteve minerale jo metalike dhe bashkëpunimi i tyre me institucione të ndryshme ndikon jashtëzakonisht shumë në mbarëvajtjen e procesit të punës, njëkohësisht dhe njohjeve me mundësi të reja dhe klientë të rinj.

Ndonëse këto ndërmarrje nuk janë të anëtarësuara në ndonjë shoqatë, në vazhdimësi janë në kërkim të mundësive të ofruara nga shoqatat apo institucionet, duke përfshirë këtu MINT/KIESA dhe kontributin e saj përmes ofrimit të mundësive për pjesëmarrje në panairë të ndryshme, të cilat në të njëjtën kohë ofrojnë rrjetëzim me biznese të tjera si dhe identifikimin e klientëve të rinj për eksport.

Gjithashtu, ndërmarrjet prodhuese të produkteve minerale jo metalike janë në kërkim të ndërlikohjes me partner relevant, dhe bëjnë hulumtime lidhur me njohjen me trendet dhe kërkesat e sektorit.

Industria e produkteve minerale jo metalike përveç interesimit që shfaq tek ndërmarrjet vendore për operim në funksionin prodhues, furnizues apo transportues, në vazhdimësi ka shfaqur interesim edhe tek ndërmarrjet e huaja për investim në këtë industri në vendin tonë.

Republika e Kosovës ofron disa përfitime për investitorët potencial të huaj dhe vendor duke përfshirë këtu:

- Taksat në Kosovë janë shumë të ulëta krahasuar me shtetet fqinje;
- Sistemi tatimor është mbajtur jashtëzakonisht i thjeshtë;
- Popullata e re dhe e motivuar, 70% nën moshën 35 vjeçare;
- Një fuqi të re dhe të motivuar punëtore me shpirt dhe aftësi të forta ndërmarrëse dhe gjithashtu njohuri të përgjithshme të shumicës së gjuhëve Evropiane;
- Resurset e lakmueshme natyrore;
- Qasje të lirë në tregun e Bashkimit Evropian dhe tregjet fqinje;
- Institucione moderne në përkrahjen e bizneseve;
- Procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë për regjistrimin e bizneseve (brenda 3 ditëve);
- Sistem të sigurt bankar;
- Strukturë moderne ligjore dhe në pajtim me BE-në;
- Monedha zyrtare në Kosovë është Euro, që eliminon rrezikun e Euro-zonave.¹¹

¹¹ Investimet në Kosovë. Integrimi Evropian

RASTE STUDIUMI - NDËRMARRJA A DHE NDËRMARRJA B

RAST STUDIUMI: NDËRMARRJA A

Në kuadër të këtij hulumtimi ndërmarrja e intervistuar si rast studiumi është themeluar në vitin 2010, fillimisht si ndërmarrje e cila merret me tregti të mallrave, ndërsa pas disa viteve ka filluar operimin si ndërmarrje prodhuese e materialeve ndërtimore, të cilat hyn në kategorinë e produkteve minerale jo metalike.

E njëjta kryesisht prodhon llaç, stiropor, fasada dhe ngjyra për ambient të jashtëm apo të brendshëm, varësisht nga kërkesa e klientëve të tij, ndërsa për prodhimin e tyre në vazhdimësi ka investuar në makineritë e shfrytëzuara nga stafi dhe njëkohësisht ka realizuar trajnime me të punësuarit në sektorin e prodhimit në mënyrë që këta të fundit të aftësohen në përdorim të makinerive.

Ndërmarrja A, aktualisht numëron afro 40 punëtorë, nga të cilët numri më i lartë i tyre është i angazhuar me punë në sektorin e prodhimit, ndërsa pjesa tjetër janë të angazhuar në shërbimin e shitjes dhe të administratës.

Në filllet e para të kësaj ndërmarrje, tregu kryesor i saj është konsideruar tregu vendor dhe shitja me shumicë. Më pas, kjo ndërmarrje ka filluar edhe eksportin në vende të ndryshme, kryesisht evropiane, ndonëse shpeshherë kushtet e eksportit konsiderohen si të vështira për ndërmarrjet vendore.

Edhe pse kjo ndërmarrje deri në këtë periudhë të operimit numëron suksese të shumta, në vazhdimësi i janë shfaqur sfida të ndryshme, ku ndër to përmendet edhe mos interesimi i fuqisë punëtore për punë në sektorin e prodhimit.

RAST STUDIMI: NDËRMARRJA B

Ndërmarrja B, e cila përgjatë intervistës është konsideruar si rast studimi, është ndërmarrja për të cilën investimi në ndërtim të fabrikës ka filluar qysh në vitin 1983, kurse ka përfunduar në vitin 1988 kur edhe veç ka filluar të operoj fabrika.

Kjo e fundit konsiderohet fabrika e vetme në rajon për prodhimin e blloqeve termo izolues të cilat konsiderohen produkte minerale jo metalike dhe të cilat përdorën mjaftë shumë në sektorin e ndërtimtarisë. Produktet të cilat kjo ndërmarrje i prodhon shprehimisht janë materiale me peshë të lehtë ndërtimore, të cilat prodhohen në mënyrë industriale, me markë të caktuar të betonit gelular, masë vëllimore të ndryshme, manipulim të lehtë dhe të shpejtë në ndërtimtari.

Kjo ndërmarrje aktualisht numëron mbi 90 punëtorë, të cilët kryesisht janë të punësuar në departamentin e prodhimit, duke u konsideruar si hallka kryesore e operimit të këtij biznesi. Ndërsa, pjesa tjetër e të punësuarve janë të ndarë në departamentin e marketingut, ligjor dhe administratë, kontabilitet financiar dhe departamentit komercial dhe shitjes.

E njëjta, kryesisht si treg kryesor e ka tregun vendor, por njëkohësisht duke qenë se është fabrika e vetme në Ballkan e prodhimit të këtyre blloqeve, në të njëjtën kohë bën eksport të mallrave në vendet fqinje, duke përfshirë Maqedoninë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë.

KUFIZIMET KRYESORE TË SEKTORIT

Pjesa vijuese paraqet analizën e fushave dhe kufizimeve kryesore të sektorit për produktet minerale jo metalike. Kufizimet dhe pengesat e identifikuar në këtë studim do të shërbejnë si pikë referimi për tu thelluar tutje në shkaqet themelore dhe propozimin e ndërhyrjeve adekuate për të përmirësuar gjendjen ekzistuese të këtij sektori.

Ky studim nxjerr në pah kufizimet e identifikuar si në vijim:

1. Vështirësitë në furnizim me lëndën e parë,
2. Pengesat në procesin e eksportit,
3. Aftësi profesional i të punësuarve në prodhim,
4. Konsumi i lartë i energjisë elektrike,
5. Nevoja për investim në makineri,
6. Ndikimi i pandemisë Covid-19.

Vështirësitë në furnizim me lëndën e parë: Studimi i Zinxhirit të Vlerës për produktet minerale jo metalike, nxjerr në pah faktin se i gjithë procesi i prodhimit të këtyre produkteve kryesisht është i varur nga furnizimi i ndërmarrjeve me lëndë të parë si material esencial për prodhim.

Duke pas parasysh se jo rrallë herë ka vonesa në procesin e transportit, ky fakt shpeshherë pezullon aktivitetin e prodhimit të ndërmarrjes në tërësi dhe ndikon në ngadalësimin e procesit të prodhimit dhe zvogëlimin e sasisë së prodhuar nga ndërmarrja.

Pengesat në procesin e eksportit: Ky studim në vazhdimësi ka paraqitur interesimin e ndërmarrjeve të tregut vendor për eksport në vendet e BE-së dhe në vende të tjera, mirëpo përkundër kësaj ndërmarrjet prodhuese hasin në kufizime të shumta të cilat shpeshherë e vështirësojnë këtë proces.

Marrë parasysh faktin se ndërmarrjet prodhuese të produkteve minerale jo metalike, kryesisht identifikimin e klientëve apo tregjeve të reja e bëjnë përmes hulumtimit në bazë vetanake, shpesh herë nuk bëhet në mënyrën e duhur. Njëkohësisht vlen të theksohet ndikimi i të dhënave të pa mjaftueshme dhe jo të besueshme të tregut.

Në procesin e eksportit ndikon mjaft shumë edhe plotësimi apo përshtatja në përpikëri e kërkesave të eksportit, duke përfshirë cilësinë, sasinë dhe arritjen në kohë të prodhimit sipas porosisë.

Si dhe mungesa e mbështetjes institucionale për pjesëmarrje në panaire rajonale apo ndërkombëtare të veçanta për këtë sektor dhe vizita studimore apo të ngjashme.

Aftësi profesional i të punësuarve në prodhim, siguria në punë: Duke konsideruar faktin se procesi kryesor i operimit për ndërmarrjet prodhuese të produkteve minerale jo metalike është vet prodhimi, vlen të theksohet se nevoja për punësimin e stafit profesional në këtë aktivitet është i domosdoshëm.

Studimi i Zinxhirit të Vlerës për produktet minerale jo metalike, thekson mungesën e interesimit të punëtorëve për t'u aftësuar dhe zhvilluar shkathtësitë e tyre në procesin e prodhimit të produkteve minerale jo metalike.

Kufizim tjetër konsiderohet edhe mungesa e kuadrove profesionale të nevojshme në procesin e prodhimit, përfshirë inxhinierët dhe teknologët, kuadrot profesionale në dizajn, inovacion, hulumtim dhe zhvillim, e theksuar kjo edhe nga ndërmarrjet pjesëmarrëse të këtij studimi.

Duke konsideruar si punë të rëndë, vlen të theksohet se në operimin e shumë prej ndërmarrjeve prodhuese vërehet mungesa e sigurisë dhe kushteve në punë për të punësuarit, gjë e cila ndikon në kushte dhe rrethana të pa përshtatshme në punë, e cila ndikon në lëndimin e punëtorëve.

Konsumi i lartë i energjisë elektrike: Procesi i operimit si ndërmarrje prodhuese e produkteve minerale jo metalike përveç nevojës për lëndën e parë, makineritë dhe fuqinë punëtore është jashtëzakonisht shumë i lidhur dhe me energjinë elektrike.

Ndërmarrjet prodhuese të këtij sektori janë konsumuese të mëdha të energjisë elektrike duke e konsideruar si pjesë kyçe e mënyrës së operimit dhe shpeshherë kjo shkakton shpenzime të mëdha tek këto ndërmarrje.

Nevoja për investim në makineri: Një ndër sfidat e identifikuara nga ky studim është dhe nevoja e ndërmarrjeve për investim në makineri.

Procesi i përpunimit të mineraleve jo metalike, ndikon dhe në mjedis andaj në vazhdimësi ndërmarrjet prodhuese të këtyre produkteve ju duhet të ndryshojnë makineritë e përdorura në makineri më ekologjike ndaj mjedisit.

Përveç ndikimit në ndotjen e mjedisit, në vazhdimësi ndërmarrjet tregojnë vështirësitë në sasinë e prodhuar meqë disa makineri imponojnë numrin e sasisë së prodhuar ngjashëm sikur dhe cilësinë dhe precizitetin gjatë procesit të prodhimit.

Ndikimi i pandemisë Covid-19: Situata pandemike gjithashtu konsiderohet si kufizim i ndërmarrjeve të këtij sektori. Meqë si pasojë e përkeqësimit dhe kufizimeve të saj, viti 2019 ishte më pak fitimprurës për thuajse të gjitha llojet e bizneseve operative në vendin tonë dhe në nivelin botëror.

REKOMANDIMET

Studimi i Zinxhirit të Vlerës për produktet minerale jo metalike ka ndihmuar në identifikimin e kufizimeve për sektorin e produkteve minerale jo metalike. Duke u bazuar në këto kufizime të identifikuar janë propozuar dhe ndërhyrjet e nevojshme, të cilat potencialisht mund të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes për sektorin e produkteve minerale jo metalike.

Kufizimet kryesore të sektorit	Arsyeja e kufizimit	Ndërhyrjet e propozuara
Vështirësitë në furnizim me lëndën e parë	Procesi i prodhimit të produkteve minerale jo metalike kryesisht është i varur nga furnizuesit me lëndë të parë dhe materiale të cilat në vendin tonë në masë të madhe janë të importuara nga vende të ndryshme. Duke pasqyruar se jo rrallë herë ka vonesa në procesin e transportit, ky fakt shpeshherë pezullon aktivitetin e prodhimit të ndërmarrjes në tërësi dhe ndikon në ngadalësimin e procesit të prodhimit dhe zvogëlimin e sasisë së prodhuar nga ndërmarrja. Përveç sasisë së lëndës së parë të importuar për ndërmarrjet të cilat furnizohen nga tregu vendor gjithashtu vërehet dukshëm mungesa e mekanizmave të cilët mbrojnë sektorin minier në nivelin vendor.	Bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve importuese dhe atyre prodhuese vendore duhet të jetë sa më i ngushtë në mënyrë që ndërmarrjet të jenë në gjendje të bëjnë porosi më të mëdha dhe njëkohësisht të marrin çmime më të përshtatshme. Promovimi i mëtutjeshëm i lidhjeve ndihmon në integrimin më të mirë të ZV-së së lëndës së parë. Investimi në teknologji (programe kompjuterike) të cilat mundësojnë parashikimin e kohës për shpenzim të lëndës së parë dhe llogaritjen e kohës së transportit për porositë e reja. Si dhe të rishikohen mundësitë për ndryshimin e mënyrës së transportit në formë të tjera alternative. Krijimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve prodhuese vendore dhe atyre importuese përmes sistemeve të informacionit, ku mund të bëhet porosia e produkteve nga klientët duke u vlerësuar stoqet e kompanisë importuese. Ndërmarrja e hapave të cilët ndikojnë në forcimin e

		mekanizmit monitorues të sektorit minerar. Të mbrohen zonat në të cilat gjenden resurset minerare nga institucionet relevante, të mos lejohet keqpërdorimi i tyre por ndërtimi i objekteve infrastrukturore në afërsi.
Pengesat në procesin e eksportit	Ndërmarrjet prodhuese vendore të cilat kanë si funksion kryesor prodhimin e produkteve minerale jo metalike në vazhdimësi shprehin interes për eksportin e produkteve të tyre. Mirëpo, përkundër këtij fakti, këto të fundit hasin në kufizime të shumta të cilat shpeshherë e ngadalësojnë procesin e eksportit. Marrë parasysh faktin se ndërmarrjet prodhuese të produkteve minerale jo metalike kryesisht identifikimin e klientëve apo tregjeve të reja e bëjnë përmes hulumtimit në bazë vetanake, përmes hulumtimit të internet dhe panairove tregtare, si kufizim konsiderohet dhe mënyra e gjetjes së tregjeve të reja meqë shpesh herë	Mbështetja e ndërmarrjeve vendore përmes trajnimeve të cilat ndikojnë në ngritjen e njohurive për identifikimin e mënyrave më të suksesshme për gjetjen e tregjeve të reja për eksport. Zhvillimi i bisedimeve të rregullta mes Zinxhirit të Vlerës dhe akterëve mbështetës të këtij sektori me qëllim identifikimin e kërkesave, përmirësimin e lidhjeve, ristrukturimin e kostove dhe ekonomizimin e zinxhirit të furnizimit/logistikës dhe çështje të tjera të cilat ndikojnë në përmirësimin e gjendjes aktuale. Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve për sektorin e prodhimit në ndërmarrje për plotësimin dhe përshtatjen e kërkesave të eksportit

	nuk bëhet në mënyrën e duhur. Njëkohësisht, vlen të theksohet ndikimi i të dhënave të pa mjaftueshme dhe jo të besueshme të tregut. Tutje, në procesin e eksportit ndikon mjaftë shumë dhe plotësimi apo përshtatja në përpikëri e kërkesave të eksportit, duke përfshirë cilësinë, sasinë dhe arritjen në kohë të prodhimit sipas porosisë. Si dhe mungesa e mbështetjes institucionale për pjesëmarrje në panaire rajonale apo ndërkombëtare të veçanta për këtë sektor dhe vizita studimore apo të ngjashme.	duke përfshirë cilësinë, sasinë dhe arritjen e kohës së prodhimit sipas porosisë. Përkrahja në masa të nevojshme të cilat mundësojnë prodhuesit vendor për ndërlidhje me tregjet e jashtme, duke përfshirë këtu pjesëmarrjen në panaire të ndryshme të produkteve minerale jo metalike të cilat konsiderohen të nevojshme për rrjetëzim.
Aftësimi profesional i të punësuarve në prodhim, siguria në punë.	Mungesë e kuadrove profesionale të nevojshme në procesin e prodhimit, përfshirë inxhinierët dhe teknologët, si dhe kuadrot profesionale në dizajn, inovacion, hulumtim të tregjeve të reja. Mungesë e interesimit të punëtorëve për t'u aftësuar dhe zhvilluar shkathtësitë e tyre në procesin e prodhimit të produkteve minerale jo metalike duke konsideruar faktin se procesi i prodhimit kërkon përvetësimin e shkathtësive të nevojshme në këtë sektor. Mungesë e stafit menaxherial, administrativ dhe të shitjes profesional dhe me përvojë.	Ofrimi i kushteve dhe mundësive për shkollim apo trajnim të specializuar, i cili ndikon në aftësimin e punonjësve si teknologë, inxhinier, dizajner, prurës të inovacionit dhe hulumtimit të tregjeve të reja. Përveç trajnimeve teorike, të trajnuarve të ju mundësohet instruktimi apo shtesa praktike e cila u mundëson atyre të zbatojnë aftësitë e reja dhe të marrin më shumë pronësi në vendin e tyre të punës. Vlerësimi i rregullt i nevojave për trajnime për të gjitha kategoritë e punonjësve duke përfshirë punonjësit në sektorin e

	Mos ofrimi i pagave nxitëse motivuese për punonjësit siç janë ato në bazë të performancës apo të tjera. Mungesë e sigurisë në vend punishtet e ndërmarrjeve prodhuese.	prodhimit, shitjes, administrimit. Përmirësimi i bashkëpunimit publiko-privat midis shkollave të trajnimit dhe ndërmarrjeve. Përmirësimi i kurrikulave dhe materialeve mësimore lidhur me shkathtësitë e nevojshme për punë me fokus në sektorin e prodhimit, mirëpo pa u kufizuar vetëm në këtë sektor. Ngritja e kapaciteteve të stafit menaxherial, administrativ dhe të shitjes përmes trajnimeve brenda apo jashtë ndërmarrjes. Zbatimi i skemave atraktive të pagesës për personelin kyç të ndërmarrjes. Krijimi i kushteve dhe rritja e sigurisë në punë në ndërmarrjet prodhuese të këtij sektori.
Konsumi i lartë i energjisë elektrike	Energjia elektrike në vazhdimësi ka krijuar varshmëri për ndërmarrjet prodhuese të produkteve minerale jo metalike, mirëpo përkundër këtij fakti procesi i prodhimit të këtyre produkteve është jashtëzakonisht konsumues i lartë i energjisë elektrike.	Ofrimi i projekteve të cilat mundësojnë shfrytëzimin e energjisë alternative për ndërmarrjet prodhuese pa u kufizuar vetëm në sektorin e produkteve minerale jo metalike. Përfshirja në projekte për energji solare, hidrocentrale apo me erë. Shfrytëzimi i makinerive të punës më ekonomike të cilat konsumojnë më pak energji elektrike gjatë procesit të prodhimit.
Nevoja për investim në makineri	Makineria e përdorur për prodhimin e produkteve minerale jo metalike	Ofrimi i projekteve të cilat mundësojnë shfrytëzimin apo investimin në makineri ekologjike, të

	shkakton ndotje të lartë në mjedis. Investimi në makineri mundëson precizitet dhe cilësi gjatë prodhimit.	cilat gjatë operimit shkaktojnë më pak ndotje duke mbrojtur mjedisin. Investimi i ndërmarrjeve në makineri të cilat janë ekologjike dhe mundësojnë mbrojtjen e mjedisit. Investimi në makineri të cilat mundësojnë prodhimin serik dhe njëkohësisht cilësor dhe preciz duke i'u përshtatur dhe kërkesave të eksportit
Ndikimi i pandemisë Covid-19	Situata pandemike gjithashtu konsiderohet si kufizim i ndërmarrjeve të këtyre sektorëve. Si pasojë e situatës së përkeqësuar me pandeminë Covid-19 viti paraprak ishte më pak fitimprurës në përgjithësi. Përveç më pak fitimprurës, kjo situatë ka shkaktuar panik dhe ka ndikuar në efikasitetin e punëtorëve.	Ofrimi i mbështetjes institucionale për ndërmarrjet e këtyre sektorëve. Adaptimi i strategjive biznesore, dhe të bërit biznes krahas trendëve aktuale të ndikuara nga pandemia Covid-19. Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe konsulencës për format e shitjes online. Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe konsulencës për format e komunikimit online.

REFERENCAT

- Aleanca e qelqit të Evropës, viti 2021, “Raporti Statistikor 2020-2021” - <https://www.wko.at/branchen/industrie/glasindustrie/statistical-report-glass-alliance-europe-2020-2021.pdf>
- DataIntelto, Produktet minerale jometalike ne nivel Global, 2020 - <https://dataintelto.com/report/non-metallic-mineral-products-market/>
- Të dhënat botërore të minim, viti 2021, Ministria Federale Republika e Austrisë Bujqësisë, Rajoneve Dhe Turizmit, Komiteti Organizativ Ndërkombëtar për kongreset botërore të minierave - <https://www.world-mining-data.info/wmd/downloads/PDF/WMD2021.pdf>
- Ibid
- Intelto, 2020, “Raporti mbi Tregun e Produkteve Minerale Jometalike” - <https://dataintelto.com/report/non-metallic-mineral-products-market/>
- Investimet në Kosovë, Integrimi Evropian - <https://www.mei-ks.net/sq/kosova/investimet-ne-kosove>
- Kirsanov, A., K., et al., 2022, “Çështjet e monopolizimit të tregut në nxjerrjen e mineraleve jo metalike në ekonomitë në tranzicion” - <https://jdmlm.ub.ac.id/index.php/jdmlm/article/view/1036>
- Raporti i Industrisë Përpunuese, viti 2020, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Departamenti i Industrisë - <https://mint.rks-gov.net/desk/inc/media/E32FFB54-40EA-415F-8577-98E0711C4980.pdf>
- Renaund. M., K., et al., 2020, “Libri vjetor i mineraleve 2017-2018” - <https://d9-wret.s3.us-west-2.amazonaws.com/assets/palladium/production/s3fs-public/atoms/files/myb3-2017-18-mk.pdf>
- Statista, Mar 6, 2022